



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË



## RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Menaxhim  
Biznesi”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Qirjazi”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Albana Madhi 
2. PhD. Eriona Shtëmbari 

Tetor/2019



## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës; 200 - 400 fjalë

Kolegji Universitar "Qirjazi", referuar në vijim (KUQ), me qendër në Tiranë, është një institucion privat i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Institucioni, ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2006 - 2007, sipas VKM Nr.274, datë 10.05.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Private "Sevasti & Parashqevi Qiriazit" (Referuar Anex\_I\_19). Kjo IAL filloi veprimtarinë me Fakultetin e Ekonomisë, me dhe pa shkëputje nga puna, në tre programe studimit, "Financë", "Drejtues Finance", "Drejtues Kontabiliteti" fillimisht me kohëzgjatje 4 vjet. Me VKM Nr. 258 datë 27.02.2008 u hap programi Banka dhe Institucionet Financiare, Administrim Publik, Marketing, Turizëm dhe Fakulteti Juridik me programin e Drejtë Biznesi (Anex\_I\_19).

Në zbatim të Ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar...", programet 4 vjeçare u riorganizuan në 3 vjeçare. Në vitet akademike 2014-2015, 2015-2016, veprimtaria e institucionit ka qenë e pezulluar. Me urdhër të MASR Nr.397 dt. 22.07.2016 Kolegjit ju hoq pezullimi i veprimtarisë. (Anex\_I\_19).

Në zbatim të Ligjit të ri Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" në vitin akademik 2016-2017 institucioni riorganizohet me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 92, datë 01.03.2017 nga Shkollë e Lartë Universitare Private "Sevasti & Parashqevi Qiriazit" në Kolegji Universitar "Qiriazit" dhe miratohet Statuti i ri (Anex\_I\_19). Në vitin 2018, KUQ përfundoi procesin e ri-akreditimit institucional (Anex\_I\_19).

Bazuar në Statin e ri, dhe Rregulloren e tij Kolegji Universitar "Qirjazi" është organizuar në tre njësi kryesore 2 fakultete dhe Kolegji i lartë profesional "Qirjazi" (Anex\_I\_1\_1\_Organigrama e Kolegjit):

1. Fakulteti i Ekonomisë që ofron programet në ciklin e parë të studimeve: "Bachelor" ("Menaxhim Biznesi", "Drejtues Finance"), si dhe në ciklin e dytë të studimeve: "Master Profesional" në ("Administrim Biznesi" dhe "Financë") dhe "Master i Shkencave" në ("Administrim Biznesi" dhe "Financë").

2. Fakultetin i Drejtësisë në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "E Drejtë Biznesi", si dhe në ciklin e dytë të studimeve: "Master Profesional" në "E Drejtë Civile dhe Tregëtare", si dhe "Master i Shkencave" në "E drejtë Civile dhe Tregëtare".

3. Kolegji Profesional i Lartë "Qirjazi" me programe 2 vjeçare të studimit "Teknologji ushqimore" dhe "Teknologji informacioni" (Urdher të MASR Nr.339 dt.21.06.2018).

Në objektivat madhore të institucionit, është përgatitja e specialistëve të lartë në fushat e programeve të ofruara duke dhënë kontributin e vet në zhvillimin ekonomik, social kulturor e shkencor të vendit tonë.

Edhe Programi i studimit BSc në "Menaxhim Biznesi" është në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të institucionit.

Programi tashmë është funksional në të tre vitet e studimit dhe këtë vit akademik, diplomohet brezi i parë i studentëve pas pezullimit. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe analizën nga vizitat në kampusin e KUQ, ekspertët e jashtëm e konsiderojnë akreditim për herë të parë të programit Bsc në "Menaxhim Biznesi".



## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Mbeshtetur ne VKM nr. 109 ASCAL ka percaktuar kohen dhe grupet e vleresimit. Gjithashtu ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm me Urdher nr. 53, dt. 18.06.2019, për akreditimin e programin bachelor në "Menaxhim Biznesi". Grupi i jashtëm i vlerësimit përbëhet si më poshtë:

1. Znj. Aviola Bardhi, Msc., menaxhere teknike e ASCAL
2. Dr. Albana Madhi,
3. PhD. Eriona Shtembari.

Pas komunikimit dhe trajnimit nga ASCAL mbi kriteret e reja të vlerësimit në ndërtesën e tyre, ekspertëve të jashtëm ju vendos ne dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktuan edhe datat e vizitave në institucion, ncdatat 26-27 Qershor, 2019. I gjithë stafi akademik dhe administrativ i KUQ u angazhua për t'iu përgjigjur kërkesave të grupit të jashtëm të vlerësimit. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datat 1-4 Korrik, 2019.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve dhe specialistes së ASCAL, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për cdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit bachelor në "Menaxhim Biznesi". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analize SWOT mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Koordinatorë Teknike e ASCAL është Znj. Aviola Bardhi.

Më datë 10.10.2019, përmes sistemit AMS, Kolegji Universitar "Qirjazi" është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm dhe me shkresë Nr. Prot. 143/55, datë 10.10.2019. Më datë 18.10.2019, KUQ përcjell shkresën me Nr. Prot. 262, datë 17.10.2019 me të cilën shpreh dakordësinë me përmbajtjen e tij.

Draft- Raporti kthehet në Raport përfundimtar.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Menaxhim Biznesi”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>			
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit bachelor në “Menaxhim biznesi” , i ofruar nga Departamenti i Manaxhim biznesit në Fakultetin e Ekonomisë të Kolegjit Universitar “Qirjazi”, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehura në planin strategjik të tij. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës bazuar në një studim të tregut të punës të përgatitur nga institucioni që përfshin: mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas, rajonal, kombëtar .		
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri. Programi i studimit bachelor në “Menaxhimi biznesi”, ruan dhe konsolidon vlerat akademike e kulturore kombëtare. (Statuti i KUQ, Neni 3, Plani Strategjik i KUQ, Rregullore e programit të studimit)		
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konstatoi që ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e KUQ dhe është bazuar dhe në një studim tregu, për të qënë konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar. (referuar dokumenteve si Statuti, Plani strategjik i KUQ, Plani strategjik i FE)		
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Nga konsultimi me dokumentat bazë dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se programi i studimit bachelor në “Menaxhimi biznesi” është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar, që reflektohet kryesisht në kurrikulën e programit të studimit. Ky program është mbështetur në “Strategjine kombëtare për zhvillim 2016-2021”, dhe përputhet me strukturën e ekonomisë shqiptare. Pas përfundimit të këtij programi studentet paisejnë me aftësi e kompetenca profesionale në fushën e menaxhimit të biznesit, me shprehje të veçanta në fushën e menaxhimit duke plotësuar dhe nevojat e tregut të punës, në nivel lokal e kombëtar.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>



<b>Standardi I.2</b>			
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ vlerësoi se ky program studimi është në përputhje e në zbatim me planin strategjik të KUQ. Strategjia e institucionit prek një sërë fushash që kanë të bëjnë me nivelin e mësimdhënies, kërkimin shkencor, specializimin e vazhdueshëm të stafit.		
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Duke analizuar dokumentat strategjikë të KUQ, (Statuti, Plani Strategjik, Rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit) dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në këto dokumenta. Pra ky program ndjek dhe zbaton misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.		
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Ky program studimi është në zbatim të VKM nr 41 Dt.24.01.2018. Programi ofrohet nga FE dhe është në përputhje me fushat e drejtimit akademike të KUQ. Programi i studimit bachelor në "Menaxhim biznesi", i ofruar nga Departamenti i Manaxhim biznesit në Fakultetin e Ekonomisë të Kolegjit Universitar "Qirjazi", është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehura në planin strategjik të tij. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës bazuar në një studim të tregut të punës.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Nga shqyrtimi i dokumentave rezultojnë se programi i studimit bachelor në "Menaxhimin biznesi", ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë, dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë ata në përfundim të tij dhe këto janë në përputhje me atë që kërkon tregu. Ky program studimi (duke iu referuar dhe rregullores së tij dhe të departamentit) ka qëllim përcësor (duke reflektuar atë se çfarë kërkon tregu i punës në këtë sektor) përgatitjen e specialistëve me njohuri e kompetenca në fushën e menaxhimit të biznesit, të aftë të mirë-orientohen në këtë fushë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me	Rezultoni se nga ana e KUQ është realizuar analiza e nevojave të tregut për hapjen/zhvillimin e këtij programi Në këtë analizë janë marrë në shqyrtim karakteristikat e nevojave të tregut. Analiza e tregut të punës merr në shqyrtim mundësitë për punësim dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>nevojat e tregut në harmoni me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar. KUQ ka bërë përpjekje për të analizuar nevojat e tregut të punës, në përshtatje me programin e studimit. Përshtatja me këto nevoja reflektohet dhe në strategjinë e zhvillimit të programit. U konstatua, gjithashtu, nga takimet në institucion me studentët se pjesa më e madhe e tyre janë të punësuar.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Përfundimi i dijeve, aftësive, shkathtësive dhe kompetencave të studentëve të ofruara nga struktura dhe përmbajtja e programit të studimit u përgjigjen nevojave të tregut të punës. Sugjerohet që të riorganizohet grupi i Lëndëve karakterizuese duke përfshirë më tepër lëndë të profilit të biznesit për të ardhur më në ndihmë formimit profesional të studentëve në fushën e menaxhimit të biznesit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.4</b> <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se KUQ ka kapacitet njerëzor në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të tij. Staf i FE është staf me përvojë dhe i kualifikuar (pjesa më e madhe) në fushat specifike që mbulojnë këtë program studimi. Nga shqyrtimi i dokumentave dhe vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore, sikurse dhe në takimet me stafin u vu re që rekrutimi i stafit të ri bëhet sipas kriterëve të mirëpërcaktuara dhe akteve nënligjore në fuqi. Sugjerohet një mbajtje me e regullt dhe me të gjitha dokumentacionin përkatës. Si dhe të ndahen në ped të brendshme dhe të jashtme</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i bachelor në Menaxhim Biznesi i ofruar nga FE dhe departamenti Menaxhimi i Biznesit në përputhje me fushën akademike e kërkimore të këtij departamenti, që është njësia bazë e ofrimit të tij. Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. U konstatua që emërtimi i këtij program është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Komiza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare</p>	<p>GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Menaxhimit, si njësia bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit si edhe në përputhje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare.</p>



e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi L5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit njesia baze përgjegjëse është DMB Ky departament ka detyren për të përmbushur qëllimin e programit. Departamenti mbulon me staf të kualifikuar shumicën e lendeve/ moduleve të programit, për pjesën tjetër angazhon staf nga departamentet e tjera të FE dhe staf të jashtëm. I gjithë procesi (pra për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit u konstatua që bëhet në mënyrë të kordinuar nga të gjitha hallkat (përgjegjëse dhe drejtuese) e strukture (organigrames) së KUQ.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe praktikave profesionale, GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara nga IAL dhe vizitave me studentet dhe stafin se KUQ ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi, të cilat ndikojnë në realizimin e të objektivave të programit të studimit (referuar Marrëveshjeve të bashkëpunimit)
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njesia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	GVJ konstatoi se në planin mësimor të këtij programi studimi praktika profesionale ze një vend të rëndësishëm, ajo kryhet në semestrin e VI të këtij program dhe ka qëllim që studentët të zbatojnë njohuritë teorike në praktike, të kete kontakte me tregun e punës etj.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Bashkëpunimi ndërmjet KUQ dhe bizneseve për berjen të mundur realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij program studimi, bëhet nëpërmjet marrëveshjeve por edhe me anë të kërkesave të vecanta. Gjithsesi u konstatua se institucioni/biznesi ku studentet kryejnë praktiken është e lidhur me fushën e studimit detyrimisht
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	KUQ pretendon se ofron trajnime të ndryshme për studentët e diplomuar. Për këtë fillimisht bashkëpunojnë me punëdhënësit për të evidentuar fushat specifike të trajnimit., por këto nuk e konstatuam nga vizita në KUQ dhe shqyrtimi i dokumentacionit.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Ekspertet e vlerësimit të Jashtëm, pas konsultimit me dokumentacionin perkates te vene ne dispozicion, gjykojne se KUQ eshte mbeshtetur ne VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 per organizimin e lendeve dhe shperndarjen e tyre ne grupet karakterizuese, te vleresuara me kredite dhe ore brenda dhe jashte auditorit/ kredit. Ky program studimi është i shtrirë në tre vite akademike, me gjashtë semestra. Çdo vit akademik ka një ngarkesë prej 1500 orësh në auditor dhe jashtë tij, që përkon me 60 kredite ECTS". Gjithashtu institucioni përcakton:" sipas formave të mësimdhënies të parashikuara në planin mësimor ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit për çdo kredit është 25 orë. Për lëndët, në auditor zhvillohen rreth 10-12 orë mësimore për kredit dhe pjesa tjetër realizohen si orë jashtë auditorit.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.	Rregullorja e programit të studimit (Aneks I_1) si edhe syllabuset e lendeve, synojne formimin e studenteve me njohuri te gjithanshme. GVJ konstatoi se Kurrikula e programit perbehet nga lëndëve të formimit karakterizues, por edhe lëndë që bëjnë pjesë në disiplina të formimit të përgjithshëm, lëndë të karakterit integruar, lëndë formuese si gjuhët e huaja, informatikë, praktika dhe lëndë me zgjedhje, sipas preferencave të tyre, të cilat i formojnë studentët, por dhe u krijojnë mundësinë atyre të orientohen drejtë një kategorie më të gjerë profesioneve e specialitetesh brenda fushës së menaxhimit të biznesit.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Synimi i programit te studimit Bachelor ne "Menaxhim Biznesi", eshte te përgatisë studentët me kompetenca për kuptimin dhe trajtimin kritik të problemeve në fushën e menaxhimit të biznesit. Me lëndët që ofron ky program, jep njohuri të gjëra në këtë fushë studimi dhe i përgatit për mundësi punësimi.



	<p>GVJ konstatoi nga vizitat ne institucion se drejtuesit e institucionit por edhe pedagoget e lendeve perkatese angazhohen maksimalisht per te sjelle njohuri koherente prane studenteve te programit. Kjo shprehet edhe ne rinovimin e përvitshëm të syllabuseve dhe pasurimin e detyrime literaturë të përditësuar të viteve tëf undit,e cila pasqyron njohuritë dhe risitë e kësaj fushe akademike dhe transmetimin e tyre tek studentët në auditor. Gjithashtu, GVJ, pasi shqyrtoi me kujdes Rregulloren e programit dhe dokumentat e tjere (si syllabuset lendore, literature e perdorur, etj) rekomandon qe programi I studimit do te pasqyronte dhe pershtaste me mire kurrikulen me nevojat e tregut te punes dhe njohurive apo kompetencave qe kerkohen sot, nese do te mbeshtetej ne nje studim te mirefillte tregu. KUQ disponon nje studim tregu (Aneksi I_12) por ne te pasqyrohen te dhena te vitit 2014, gjithashtu nuk pasqyron metodologjine statistikore te perpunimit te te dhenave.</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Kurrikula e programit perbehet nga lende dhe module te cilat synojne ti pajisin studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale në fushat specifike ku ata studiojnë. Syllabuset e lëndëve që përbëjnë këtë programstudiminë ndërtimeve tyre, e cila pasqyrohet tek temat e leksioneve që trajtohen gjatë zhvillimit të tij, transmetojnë një nivel të avancuar informacioni në këtë drejtim, i cili i afteson studentet përzgjidhjen e problemeve komplekse ne fushen e menaxhimit te biznesit.</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Pas shqyrtimit te dokumentave bazë: Kurrikulen e programit nen vleresim, Planin mësimor, Programet mësimore (Syllabuset) e lëndëve/moduleve përbërëse, si edhe Rregulloren e programit të studimit, GVJ gjykon qe ky kriter permbushet dhe programi pasqyron elementet e përcaktuara në VKM Nr.41 datë 24.01.2018. Kontrolli i dijeve kryhet me anë të detyrave/projekteve të kursit individual ose në grup dhe provimeve të ndërmjetme dhe forma të tjera të cilat janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Grupet e seminarit janë në përputhje me tabelën 2 të VKM 41, me më pak se 35 studentë/grupi.</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit është i ndarë në module dhe lënde me karakter formues dhe profesional, duke respektuar peshen e kategorive të lëndëve (A, B, C, D, dhe E), ne mbeshtetje te VKM Nr.41 datë 24.01.2018. Gjithashtu kreditet (ECTS) specifikohen në përputhje me raportin e orëve teori/praktikë. Sugjerohet qe grupi B – (Lende karakterizuese) te riorganizohet duke perfshire me toper lende te profilit te biznesit per ti ardhur me ne ndihme formimit profesional te studenteve ne fushen e manaxhimit te biznesit. Kjo duke pare perqindjen qe zene lendet e profilit te biznesit (16%) perkundrejt 28% lende te profilit kontabilitet-finance, brenda lendeve te grupit B.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1749 804 1816">Përcaktuar</th> <th data-bbox="804 1749 1021 1816">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1021 1749 1238 1816">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1238 1749 1402 1816">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1816 804 1861"></td> <td data-bbox="804 1816 1021 1861"></td> <td data-bbox="1021 1816 1238 1861" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1238 1816 1402 1861"></td> </tr> </tbody> </table>	Përcaktuar	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Përcaktuar	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							



**Standardi II.2**

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Veprimtaria e KUQ u pezullua në vitet akademike 2014-2015, 2015-2016, dhe u ri-hap me urdhër të MASRNr.397dt.22.07.2016. Në vitin 2018, KUQ përfundoi procesin e akreditimit institucional (Anex_I_19 Aktene ligjore KUQ).</p> <p>GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin baze dhe gjen perputhshmeri te rregulloreve te fakultetit dhe departamentit si njesi kryesore/baze per ofrimin e programit te studimit, me Ligjin 80/2015, Për Arsimine Lartë dhe aktet nënligjore që rrjedhin nga ai.</p> <p>(Anex_I_1_Rregullorja e KUQ, Kreu I-II; Anex_I_5_Manuali i cilësisë; Anex_II_1_Rregullorja e FE, neni 1,5,6; Anex_II_1_Rregullorja e Departamentit MB, neni 1)</p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Në KUQ, përgjegjësi i departamentit luan rolin e koordinorit dhe zbatuesit të programit të studimit nën shqyrtim (Anex_II_1_Rregullorja e Departamentit MB, neni 1). Ai drejton të gjithë veprimtarinë mësimore dhe shkencore, kontrollin e tij si dhe kryerjen e praktikave profesionale në përputhje me objektivat e caktuara.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit informon në vazhdimësi Dekanin e FE për ecurinë e zbatimit të programit.</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë në KUQ përbëhet nga 2 departamente dhe një qendër kërkimore-shkencore.</p> <p>Fakulteti Ekonomik dhe departamenti Menaxhim Biznesi si Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti ka në përbërjen e tij 7 pedagogë, nga të cilët 3 janë me grade shkencore (Reforohuni Tabela 1 dhe 2, "Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) të Departamentit të Administrimit Biznesit, për vitin akademik 2018-2019). Gjithashtu drejtuesit e FE dhe Departamentit të Menaxhimit të Biznesit kanë tituj shkencorë, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015.</p> <p>Pas vizites në institucion, GVJ rekomandon te plotësohet dhe firmoset dokumentacioni përkatës në zyrën e Burimeve Njerëzore, si edhe të krijohen kushtet për akomodimin e stafit efektiv me zyra në institucion.</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>									
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>									
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

**Standardi II.3**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit ka informacionin e nevojshëm dhe mbëtetet në Rregulloren e Brendshme të FE dhe Rregulloren e programit të studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi”, për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. (Ref. Aneksi III_2 Dosja e programit të studimit)
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	KUQ ka organizuar programin e studimit nën shqyrtim bazuar në VKM Nr.41, datë 24.1.2018, “Për Elementët e Programeve të Studimit” dhe plani mësimor është idetajuar sipas Veprimtarive Formuese (A-E), kjo e pasqyruar në Anex III_1_Rregullore e programit të studimit Bsc “Menaxhim Biznesi” dhe Anex III_2_Dosja e programit Bsc “Menaxhim Biznesi”. Në planin mësimor të këtij programi studimi përcaktohen lëndët/modulet e programit të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese: A -Lëndë Bazë 18 % me 33 ECTS me 6 lëndë B- Lëndë Karakterizuese 53 % me 95 ECTS me 16 lëndë C-Lëndë Interdisiplinore/Integruese 15% me 27 ECTS me 5 lëndë D- Lëndë plotësuese 11% me 20 ECTS me 4 lëndë E – Detyrimet përmbyllse 3% me 5 ECTS me 1 lëndë. Programi i studimit është i ndarë në tre vite studimi me 6 semestra ku secili semester me 15 javë mësimore, ndërsa semestri 6 ka 10 javë. Sugjerohet (si edhe në Standartin II.1, kriteri 6. me sipër) që grupi B – (Lëndë karakterizuese) të riorganizohet duke përfshirë me të paktën lëndë të profilit të biznesit për të ardhur me në ndihmë formimit profesional të studenteve në fushën e menaxhimit të biznesit.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Kurrikula e programit të studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi”, në KUQ është e organizuar në lëndë e module, të cilat janë të vlerësuara me kredite ECTS ku 1 ECTS – 25 orë mësimore punë e studentit. <i>1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor</i> <i>1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor</i> <i>1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit</i> <i>1 orë mësimore 50 minuta.</i> Këto informacione janë të detajuara në Rregullore e programit (Anex III_1) dhe Aneksi III_2 “Dosja e programit të studimit”- “Për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve”.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve	Nga konsultimi me dokumentat baze (Rregullore dhe Dosja e programit të studimit), si edhe vizitat në institucion, rezultojnë që Programi i studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi” bazohet në Planin Mësimor, i cili përbën dokumentin kryesor për zbatimin e këtij programi dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Ai pasqyron informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në



etj.	auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve.			
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>GVJ konstatoi se KUQ është transparent përsa I përket procedurave dhe kriteretë përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto informacione pasqyrohen në Rregulloren e programit të studimit në Bsc “Menaxhim Biznesi” e cila bazohet gjithashtu në Rregulloren e institucionit dhe Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe specifikiisht në Anex_I_14_Kriteret e pranimit et ransferimit të studentëve.</p> <p><i>Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhet publik në faqen internetit të Kolegjit, rrjetet sociale, në broshurën informuese dhe gjatë fushatës mediatike.</i></p> <p>Gjate vizitave ne sekretarine mesimore te KUQ, GVJ konstatoi nje procedure normale transferimi, ku për pranimin e studentëve të transferuar institucioni ngre një komision ad hoc nga departamenti I cili bën dhe ekuivalentimin e lëndëve.</p> <p>Sugjerohet te perditësohet Rregullorja e programit me kerkesat ligjore per pranimin dhe transferimin e studenteve dhe te pasqyroje qarte kriterin e notes mesatare (nbi 6).</p>			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Syllabuset e lendeve te programit nen shqyrtim permbajne informacion te detajuar për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, dhe janë hartuar në përputhje me formatet ligjore të përcaktuara. Procedura e gartimit te tyre kalonte nga titullari i lëndës/modulit, shqyrtohej në departament dhe miratohej nga përgjegjësi i departamentit dhe Dekani i fakultetit.</p> <p><i>Syllabuset përmbajnë informacione të përgjithshme si titulli i lëndës/modulit, emrin e titullarit që e zhvillon, ngarkesën në orë dhe kredite, tipologjinë e lëndës (kategorinë), vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda, llojin e lëndës, programin mësimor të cilit i përket, kodin e lëndës/modulit dhe adresën elektronike të titullarit të lëndës.</i></p>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Programi i studimit nen shqyrtim është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. KUQ ka komisionet lëndore te cilat se bashku me departamentin e Menaxhimit te Biznesit, në fillim të çdo viti akademik, diskutojnë përmbajtjen e programeve të studimit dhe problematikat e hasura.</p> <p><i>Ndryshimet eventuale pasi miratohen në departament e fakultet arkivohen në sekretarinë mësimore. Ato pas miratimit janë reflektuar në të gjithë elementët e dosjes së programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit është përcaktuar në rregulloren e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe pasqyrohet edhe në planin mesimor. Sipas kësaj rregullore, <i>studentët duhet të realizojnë një sasi mesatare prej 60 kreditesh</i> krediteve të grumbulluara për çdo vit akademik. Në përfundim të programit të studimit studentët duhet të plotësojnë 180 kredite në mënyrë që të mund të diplomohen. Programi I studimit nën shqyrtim, <i>shtrihet në tre vite akademike, i ndarë në 6 semestra, i organizuar mbi bazën e lëndëve ose moduleve dhe i vlerësuar me kredite (ECTS).</i>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Kurrikula e programit detajohet në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve/moduleve. Programi i studimit “Menaxhim Biznesi” synon t’i ofrojë studentëve njohuritë e nevojshme për t’ju mundësuar punësim në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Ai është i organizuar në lende të karakterit të përgjithshëm dhe profesional (sipas legjislacionit në fuqi) dhe gjithashtu parashikon kryerjen e një praktike dy javore gjatë semestrit të fundit të studimeve. Sipas analizave periodike, vjetore të punës mësimore të Senatit, Fakultetit dhe departamentit, rezultojnë se programi ka një ngarkesë të plotë mësimore dhe raport të ekuilibruar teori - praktikë. Megjithatë, sugjerohet që institucioni t’i krijojë me tepër mundësi dhe sugjerohet që studentëve kryerjen e këtyre praktikave pranë biznese si avantazh për profilit e tyre të studimit, përkundrajt kryerjes së kësaj praktike në sektorin bankar.
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektiveve formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.	<i>Ngarkesa e programit, në orë mësimore (1500 orë) dhe kredite (180 ECTS), i përmbahen përcaktimeve ligjore për këtë cikël studimi dhe e përfaqëson atë meprograme të tjera të ngjashme ndërkombëtare.</i> Për të përmbushur plotësisht këto kriter si edhe për të realizuar me mirë objektivat e programit, sugjerohet (si edhe në Standardin II.1, kriteri 6, me siper) që grupi B – (Lende karakterizuese) të riorganizohet duke përfshirë me tepër lende të profilit të biznesit për të ardhur me në ndihmë formimin profesional të studentëve në fushën e menaxhimit të biznesit.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilit e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<i>Ngarkesa e programit, në orë mësimore (1500 orë) dhe kredite (180 ECTS), i përmbahen përcaktimeve ligjore për këtë cikël studimi dhe e përfaqëson atë meprograme të tjera të ngjashme ndërkombëtare.</i> Për të përmbushur plotësisht këto kriter si edhe për të realizuar me mirë objektivat e programit, sugjerohet (si edhe në Standardin II.1, kriteri 6, me siper) që grupi B – (Lende karakterizuese) të riorganizohet duke përfshirë me tepër lende të profilit të biznesit për të ardhur me në ndihmë formimin profesional të studentëve në fushën e menaxhimit të biznesit.
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektiveve formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi” pranë KUQ është i ndarë në lende dhe module formuese ku peshën më të madhe e zënë ato tipit karakterizues (53%), duke ruajtur raportet formimit teorik dhe praktik (sipas ligjit). Kjo gje mundëson transferimin dhe mobilitetin e studentëve në institucion dhe jashtë tij.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Drejtpërdrejt dhe stafi akademik i KUQ punon për përditësimin e vazhdueshëm të literaturës çdo fillim semestri, kjo e pasqyruar në syllabuset përkatëse të lëndëve. Disa prej anëtarëve të stafit akademik japin kontributin personal me publikime shkencore të cilat i vihen në dispozicion edhe studentëve. <i>Nga analizimi i syllabuseve të programit të</i>



	<i>studimit Bsc në "Menaxhim Biznesi", vihet re që në pjesën më të madhe kaburime të shfrytëzueshme literature të 5 viteve të fundit.</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	<p>Programi i studimit synon ti ofrojë me se miri studenteve përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të nevojshme në perfundim të ciklit të parë të studimeve. Kjo e pasqyruar në rregulloren e programit të studimit (Anex_III_1) dhe përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënësve nësyllabuset e lendeve të ofruara (Anex_III_2_4)</p> <p><i>KUQ shprehet në raportin e tij të vlerësimit, se studentët pas përfundimit të programit të studimit kanë fituar aftësi të tilla si:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të njohin dhe të kuptojnë saktë pasqyrat financiare të një biznesi</li> <li>2. Të realizojnë analizë të mirëfilltë të pasqyrave financiare</li> <li>3. Të mund të auditojnë pasqyrat financiare dhe veprimtarinë e një biznesi</li> <li>4. Të kuptojnë funksionimin e institucioneve financiare</li> </ol> <p>GVJ sugjeron të rishikohen aftësitë që studentet përfitojnë në perfundim të programit dhe të përshatën një profil të Menaxhimit të Biznesit. Kjo gjithashtu duhet të reflektohet specifikisht në Rregulloren e Programit si edhe në praktikën mësimore të studenteve pranë institucioneve private apo shtetërore të biznesit. Edhe pse institucioni ka një listë të plotë bashkëpunimesh, praktikën kryhen në sektorin bankar.</p>			
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Programi i studimit integron lende nga fusha të ndryshme të ekonomisë, gjë e cila i hap dyert studenteve për të vijuar me tej karrierën e tyre akademike ose punësim pas mbarimit të programit. KUQ kthapdy programet e studimit në nivelin Master (MSc dhe MP), brenda departamentit të Menaxhim Biznesi, ku studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor në MB dhe nga programet e tjerat e studimit brenda FE mund të thellojnë njohuritë e tyre.</p>			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	<p>GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për përshtatjen samëshme të programeve të ofruara me kërkesat e tregut të punës. KUQ ben analizat vjetore të punës mësimore të kryera në nivel Fakulteti dhe departamenti për programin e studimit, duke analizuar propozimet e sjella në lidhje me ndryshimet e mundshme të tij.</p> <p>Per të realizuar sa më mirë këto objektiv dhe përmbushur këto kriter, GVJ sugjeron kryerjen e një studimi të mirëfillte tregu, ku të analizohen nevojat e tregut të punës sot dhe identifikimin e e atyre moduleve/lendeve të reja që do të pasyrojnë kurrikulen e programit të studimit. Gershetimi I këtyre nevojave me njohuritë profesionale do të mundësonin përgatitjen e specialisteve që i mungojnë tregut të punës sot. Kjo gjë do t'i jepje një avantazh konkurrues edhe vetë institucionit në të ardhmen.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Asnjë</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	



**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëhme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar ne programin e studimit Bsc "Mcnaxhim Biznesi", është në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Në realizimin e programit të studimit janë angazhuar 19 pedagogë, nga të cilët 13 janë efektiv, 10 me tituj e grada shkencore, 6 me kohë të pjesëhme të gjithë me tituj e grada shkencore.</p> <p>GVJ rekomandon (si ne standartin II. 2 me lart) te plotësohet dhe firmoset dokumentacioni përkatës në zyrën e Burimeve Njerëzore, si edhe të krijohen kushtet për akomodimin e stafit efektiv me zyra në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëhme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëhme që angazhohen në realizimin e programit të studimit është i larmishem si ne tituj e grada ashtu edhe ne eksperiencen profesionale. Institucioni ka angazhuar pedagogeve të kategorisë "Profesor" të cilët pëcjellin përvojën në fushat që mbulojnë dhe njekohesisht mbështesin kualifikimin e pedagogëve me të rinj, të atashuar pranë tyre. Disa prej tyre kanë kryer kualifikime e specializime jashtë vendit sipas fushave përkatëse dhe disiplinave që mbulojnë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik I angazhuar ne program është me tituj dhe grada shkencore te cilat perkojne me natyren specifike te moduleve qe mbulojne. Kualifikimi akademik dhe fushat kërkimore të tyre I përgjigjen natyrës dhe specifikave të lëndëve e moduleve që ata zhvillojnë dhe një pjesë e mire e tyre kanë një përvojë të gjatë pune në këtë drejtim.</p> <p><i>Departamenti i MB bën një politikë të zgjedhur me kujdes për angazhimin e stafit akademik në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Duke pasur parasysh numrin e vogel te studenteve ne total por edhe te atyre qe dïlpomohen dhe kryejne praktiken profesionale, KUQ permbush detyrimet ligjore duke respektuar edhe raportin pedagog/student per udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. Përzgjedhja e institucionit/subjektit në të cilin do të zhvillohet praktikaprofesionale behet ne bashkepunim me Zyren e Karrieres.</p> <p>KUQ ka organizuar konferenca shkencore ne bashkepunim me institucione te tjera, ka marre pjese ne panaiire pune, etj. Keto dhe veprimtari të tjera specifike që janë kryer nga Fakultetisi psh. leksione të hapura, departamenti ka vënë në dispozicion dhe ka mbuluar me personel akademik duke bashkëpunuar ngushtësisht me studentët për tërritur nivelin e pjesëmarrjes së studentëve dhe përfshirjen e tyre në këto veprimtari.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe</p>	<p>Ky kriter garantohet nga numri i vogel i studenteve qe ka ky insitucion.</p>



<p>garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Ne lenden e informatikes e cila ka ore laboratorike seminarret dhe puna në laborator realizohen nga pedagogu i lëndes së informatikës, i cili kujdeset për mirëmbajtjen e paisjeve laboratorike e mjediseve të tjera mësimore si dhe të teknologjisë së informacionit që përdoret në procesin mësimor. <i>Sherbime te internetit dhe riparimin e pasijeve elektronike janë mirëmbajtur nga firmat me të cilat ka kontrata sherbimi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Shkallë e përmesueshmërisë</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Shkallë e përmesueshmërisë</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	GVJ konstatoi qe Kolegji Universitar "Qiriazi" ka një udhëzues për kualifikimin e stafit akademik, sidomos të personelit të ri. Pedagogët e rinj njiheshin me Ligjin 80/2015, aktet nënligjore dhe udhëzimet e MASR për IAL, me Statutin, Rregulloren e Kolegjit, fakulteteve, departamenteve dhe programeve të studimit. Stafi akademik me pervojë kryqjente leksioneve të hapura KUQ ka hartuar një udhëzues për sistemin informatik dhe metodat e mësimdhënies të kolegjit për menaxhimin e sigurimin e informacionit didaktik për pedagogët e studentët në Website e KUQ-it. (Anex_I_7_1_Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik; Anex_I_18 Sistemi informatik dhe metodat e mesimdhënies; Anex_I_7_2_Kriteret e vlerësimit për punë si staf akademik)
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Shqyrtimi i akteve të brendshme të KUQ si dhe i dosjeve personale të pedagogëve nxjerr në pah se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është aktiv në publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore. Puna kërkimore dhe botimet lidhen me fushën kryesore të studimit të këtij programi. Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik monitorohet në mënyrë periodike nga KUQ. Si instrumente përdoret pyetësori me studentët i cili realizohet para provimeve, rezultatet e anketimit te përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Përgjatë vitit akademik, realizohen kontrole periodike nga departamenti "Menaxhim Biznesi" në bashkërendim me NJSBC,
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet anketave dhe pyetësorëve. Por sygjerohet qe keto anketa te behen me shpesh dhe perfundimet tju behen te ditura dhe studenteve.
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Strukturat përgjegjëse (njësia bazë dhe kryesore) bëjnë publike rezultatet në analizën vjetore të njësisë. Këto rezultate fillimisht diskutohen në një mbledhje të hapur departamenti. Vetëm pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira,	Nga takimet ne institucion konstatuam se FE përdor mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Pyetësori i studenteve përdoret si mjet për të evidentuar



<p>nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>dhe vlerësuar shembuj të mirë dhe efikas në procesin e mesimdhënies dhe mësimnxënies. Raster e specifikuar si pozitive nga studentët bëhen të ditura në mbledhjet e departamentit. Trajnimet dhe kualifikimet e stafit në përputhje me fushat e studimit si dhe përfshirjen në veprimtari të ndryshme shkencore është njera nga format e perdorura por edhe mobilitetet në kuadër të marrëveshjeve me institucione arsimore brenda vendit dhe jashte vendit. (Anex_I_13_Lista e bashkëpunimit institucional; Anex_I_15_1,2 _Raportet vjetore (2015-2016;2017-2018); Anex_II_3_Analizat vjetore të FE; Anex_II_5_1_Analizat vjetore të Departamentit MB; Anex_I_7_1_Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik ; Anex_II_12_Pyetëtori i studentëve)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.2</b> <b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të njohurive përfshijnë: leksione, seminare/orë laboratorike, detyra/projekte kursi, praktikë profesionale, tema diplome/ provim formimi. 60 kredite ne vit, totali 180 kredite.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve janë të paraqitura në syllabuset dhe programet e lëndëve e moduleve. Format e mësimiit teorik e praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit/projektet e kursit, etj. Format e kontrollit të dijeve janë testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit. Provimi i formimit bëhet me mbrojtje të temës së diplomës ose provim.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Personeli akademik mbështetet nga institucioni për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave. Stafit akademik, përdor mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive. Kolegji ka paisur të gjithë pedagogët me kompjutera dhe zyrat e tyre me internet. Keto ndihmojnë procesin e mësimdhënies e mësimnxënies në përputhje me objektivat formuese dhe kërkesat aktuale të punëdhënësve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në kete program studimi plotëson të gjitha kriteret ligjore të kualifikimit.</p>



kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Autoritetet drejtuese rezultojnë me tituj akademik, duke qenë të angazhuar me kohë të plotë në Institucion. Për lëndët dhe modulet ekzistojnë tekste, leksione dhe materiale të tjera që u vihen në dispozicion studentëve, edhe nëpërmjet librarisë, por jo gjithmonë. U evidentua që aty ishin vetëm një numër i kufizuar i literaturës mbështetëse.			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Kontrollat e vazhdueshme dhe leksionet e hapura të organizuara nga dekanati dhe departamenti identifikojë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësi i studentëve.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Orët e mësimi janë interaktive, ku studentët bashkëveprojnë me pedagogët dhe njëri-tjetrin, sidomos në orët e seminareve. Nga vizita në institucion mësuam se personeli akademik përpiqet që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës për ta bërë më tërheqëse orën e mësimi.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Format dhe metodat e mësimdhënies në KUQ, veçanërisht inkurajimi i diskutimeve dhe debateve gjatë orës së mësimi, ndihmon studentët në shprehjen e mendimit të tyre dhe krijimit të një autonomie të menduarit dhe të gjykuarit. Numri i vogël i studentëve në këtë program studimi, u jep mundësi pedagogëve që ti lejojnë studentët të diskutojnë me shumë dhe të shprehin hapur opinionet e tyre, duke vendosur edhe një marrëdhënie të ndërsjellë respekti midis tyre, gjë e cila u vu re edhe gjatë vizitave në institucion dhe intervista me studentët.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Plot përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi mësimor për programin e studimeve zhvillohet te Kolegji Universitar "Qiraizi", i ndodhur në kampusin universitar të KUQ, ushtron aktivitetin e tij në një godinë si model arkitekture e ndërtuar që në vitin 1925. Sipas orarit të mësimi semestral, studentët zhvillojnë mësimin (leksione, seminare, laboratore) në mjedise të mjaftueshme për numrin e studentëve, të grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Ajo është e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambientet, internet, vende çlodhjeje e qëndrimi, projektorë, sistem mbrojtjeje nga zjarri,



	shërbim, ndihme të shpejtë. Kolegji Univeritar "Qiriazi" mirëmbahet dhe plotëson të gjitha standartet për infrastrukturën.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Nga konstatimi u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat dhe laboratorët janë të pajisura me mjetet e nevojshme të përshtatshme për mësimdhënie si kompjutera (desktop, laptop), videoprojektorë, lidhje interneti, etj. Nga ana tjetër, ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre", sipas të cilit kërkohen 2.5 m <sup>2</sup> / student
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Në funksion të cilësisë së mësimdhënies në KUQ dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, janë edhe dy laboratorët e teknologjisë informacionit dhe i gjuhëve të huaja, të kimi-biologjisë dhe elektronikës. Laboratorët kanë 25-45 poste të pajisura me teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike sipas specifikave (kompjutera, sistem audio, poste të ndara, etj.). Të gjitha sallat e leksioneve e seminareve në godinën e KUQ dhe të laboratorit janë të mbuluara me linjë interneti e cila krijon mundësinë e lidhjes dhe të transmetimit të leksioneve të veçanta on-line apo dhe shërbime të tjera nga sistemi i IT.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë për çdo modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Materialet fizike ofrohen në librarinë e kolegjit. Materialet e tjera si p.sh ppt. të leksioneve jepen nga pedagogët, në faqet e tyre personale Sipas RVB, Institucioni zotëron edhe libra të huaj dhe të autoreve shqiptare në bibliotekë, por nga vizita në Bibliotekë rezultoi se numri ishte i kufizuar dhe botime të vjetra
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Kolegji vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet bibliotekës dhe kancelarise, tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazë të planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. Vene në dukje që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, duhet të pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhurnimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga vizita në Institucion rezultoi që biblioteka nuk përdoret shumë nga studentët.
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë librarinë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Në RVB theksohej për aksesin në librarinë online, por kjo nuk na rezultoi kur vizituam bibliotekën. Kolegji po përpiqej të përfshihet në Bibliotekën Dixhitale të mundësuar nga RASH.
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave	Konstatuam se në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, janë edhe dy laboratorë të teknologjisë informacionit. Laboratorët kanë 15-22 poste të pajisura me teknologjinë e nevojshme për zhvillimin



dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	e punës laboratorike sipas specifikave (kompjutera, programe e duhura etj). Laboratorët janë pjesë e programit mësimor dhe shfrytëzohen rregullisht nga studentët. Ato janë në dispozicion të studentëve deri në orën 16.00								
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Sipas RVB dhe vizites ne Kolegj, institucioni ofron për stafin akademik dhe studentët e KUQ një platformë online (e-learning). Kjo platformë është organizuar dhe përshtatur në bazë të strukture organizative të KUQ. Kjo platformë është mjaft efiçase në shpërndarjen e informacionit në kohë reale, komunikimit dhe vlerësimit të vazhduar gjatë gjithë vitit akademik. Platforma është bërë e njohur për të gjithë stafin akademik dhe studentët për mënyrën e lehtë dhe të thjeshtë të aksesimit qoftë nëpërmjet faqes zyrtare të website www.qiriazi.edu.al, ose nga pajisjet smart phone nëpërmjet moodle application. Nga ana e tij, institucioni mbështet dhe nxit permes informimit dhe scsioneve trajnuese stafin dhe studentet e KUQ për përdorimin e platformës online elearning. Aksesimi i kesaj platformë [1] mund të behet shume thjesht duke klikuar “Portali i Studentit” në faqen zyrtare të KUQ [2]								
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Në KUQ sistemi i komunikimit të zhvillohet nëpërmjet platformës Moodle (E-Learning) si edhe nëpërmjet faqes zyrtare të webit. Që në momentin e regjistrimit studenti pajiset me user name dhe password për llogarinë e tij, gjithashtu, çdo pjestar i stafit akademik ka llogarinë e tij e cila është krijuar nga sektori i IT dhe më pas menaxhohet nga vet ai. Çdo student dhe pedagog, kanë në dispozicionin e tyre një udhëzues të përgatitur nga sistemi IT i cili njihet përdoruesit me mënyrën e funksionimit.								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Personeli akademik i KUQ, orienton studentet, sigurisht kur studenti përmbush kriteret e përcaktuara në rregullore, te perzgjedhe sipas dëshires se tij te zehen e diplomës që kërkon të zhvillojë, të zgjedhë udhëheqësin e tij dhe në bashkëpunim më të, të përcaktojë temën kërkimore që do të realizojë për mbrojtje. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale. Tezat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i fakultetit. Gjatë punës kërkimore për arrijten e objektivave të përcaktuara në realizimin e punimit të diplomës, udhëheqësi asiston gjatë gjithë kohës studentin dhe e mbështet atë për përmbylljen me sukses të saj.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Asnjë përmbushje</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë	Në institucion është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si njësi bazë e përhershme për të ndihmuar dhe kontrolluar në garantimin e përmbushjen e standardeve në këtë drejtim, e cila perbehej



<p>përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>vetem nga një person. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamentet, dorëzojnë në Rektorat çdo fund viti akademik, një raport vjetor, i konceptuar si një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë. Ky raport shërbën për të patur një pasqyrë të fakultetit dhe për tu përmirësuar në vazhdimësi. Personi përgjegjës për cilësinë e mësimin në nivel fakulteti në FE aktualisht është Dekani për mësimin dhe kurrikulat Ai ndjek dhe kontrollon gjithë veprimtarinë mësimore në FE. GVJ sygjeron në shtimin e stafit të NJSBC.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësi kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Menaxhim Biznesit në bashkëpunim me njësitë bazë të tjera të institucionit, si dhe me NJSBC, me anë të kontrolleve të vazhdueshme por edhe me anë të organizimit të diskutimeve të brendshme synojnë rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Dekani i FE, si drejtues i fakultetit drejton gjithë punën mësimore, shkencore dhe përmirësimin e tyre të vazhdueshme. Përgjegjësi i departamentit të Menaxhim Biznesit, si njësi bazë, ka përgjegjësinë e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të masave për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. FE dhe DMB, duke u mbështetur në kontrollin e vazhdueshëm dhe masave të marra, të leksioneve të hapura të organizuara, si dhe të analizës së vazhdueshme të punës mësimore dhe kërkimit shkencor, krijojnë frymën e përgjegjësisë individuale të personelit akademik për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Në kuadër të zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies, DMB organizon leksione të hapura si nga titullaret e lëndëve ashtu edhe nga perfaqësuesit e departamentit dhe Fakultetit. Departamenti Menaxhim Biznesi ka krijuar hapësirë për lëndë e module që pedagogët të përdorin metoda të reja inovative të mësimdhënies. Ai ka inkurajuar stafin akademik, sidomos atë të ri, për përvetësimin e metodave të reja të mësimdhënies në fushën e ekonomisë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në tërësinë e aktiviteteve të Kolegjit Universitar "Qiriazi" një vend të rëndësishëm zë rritja e vazhdueshme e nivelit kërkimor-shkencor të pedagogëve me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit transmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Kjo gjë konfirmohet dhe në CV e stafit akademik që shikohet se në këto vitet e fundit kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Ky kualifikim i personelit akademik të Fakultetit dhe departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në vazhdimësi personeli akademik i Fakultetit Ekonomik dhe departamentit të Menaxhim Biznesi, kualifikohen brenda institucionit, në zbatim të udhëzuesit të stafit akademik si dhe në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes tryezave të rrumbullakta, diskutimeve, leksioneve të hapura i kanë shërbyer trjanimit të stafit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe të metodave të reja në mësimdhënie</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik</p>	<p>Ka qënë dhe është në përgjegjësinë e personelit akademik zbatimi i</p>






<p>dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>programeve të studimit si dhe transmetimi i metodave të reja në mësimdhënie dhe praktikave mësimore tek studentët. Ky është një detyrim i cili rrjedh nga marrëdhëniet e punës që ka stafi akademik në lidhje me realizimin e procesit mësimor të përcaktuara në kontratën e punës. Në fillim të semestrit pedagogu harton planin kalendar të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, që firmoset nga ai dhe përgjegjësi i departamentit. Pedagogu është përgjegjës për të gjitha zërat e detyrave që ai ka në marrëdhënie me studentët për organizimin dhe zhvillimin e mësimit si dhe plotësimin e detyrave që i ngarkon departamenti</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i strukturave drejtuese të KUQ për t'u siguruar atyre si informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit,</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Jo e përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b> <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve, rezulton nga dokumentacioni si dhe nga vizita në institucion, përdorimi i metodave të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, teste me alternativa përgjigjesh si dhe provime përfundimtare me gojë e shkrim. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit Ekonomik dhe në rregulloren e programit të studimit Bsc në MB. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të Kolegjit, si dhe të vendosura në stendat e Kolegjit. Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së KUQ realizohet nëpërmjet: (1) angazhimit në diskutime gjatë seminareve, por edhe në formë kolegjumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës, (2) detyrave të kursit për problematikën e disiplinës (3) provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës. Për çdo modul/lëndë, mënyra e kontrollit të njohurive përcaktohet në syllabusin përkatës. Sistemi i vlerësimit të studentëve është i njëjtë për të gjitha programet në nivelin Master dhe realizohet nëpërmjet sistemit të pikëve 0-100 të cilat konvertohen në nota (4-10). Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara ku ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive vlerësohen me 10%, plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) me 10%.</p>



	testimet gjatë vitit (ose provimi ndërmjetëm) me 20% dhe në fund kryhet provimi përfundimtar, i cili vlerësohet me 60%. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve. (Anex_I_3_Rregullore e KUQ; Anex_II_1_Rregullore e FE; Anex_III_1_Rregullore e programit të studimit Bsc në MB; Anex_III_2_4_Syllabus_BCH_MB)			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita ne kolegji konstatuam se pedagogu i lëndës para fillimit te çdo semestri bën prezantimin e e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat lëndës si dhe elementët e tjerës të syllabusit. Gjithashtu i njeh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës. Format e kontrollit të njohurive: a) Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja active, b) Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit), c) Testimet gjatë vitit d)Provimi përfundimtar, etj</p> <p>Bazuar në rregulloret e studimeve të KUQ-së, Rregulloren e FE, rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që i ka përvetsuar studenti gjatë zhvillimit teroik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Detyrat e kontrollit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Ato organizohen në javën e tetë të çdo semestri, mbi bazë grupi mësimor dhe vetëm gjatë orve të planifikuara në seminare. Detyrat e kontrollit organizohen vetem me shkrim. Pjesë e vlerësimit janë dhe projekte kursi ose detyra kursi në varësi të modulit. Provimi final organizohet: me shkrim, me gojë ose i kombinuar (me shkrim e me gojë). Mënyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor nëpërmjet evidentimit të syllabuseve të lëndëve. Grafiku i provimeve hartohet nga përgjegjësat e departamenteve dhe miratohet nga Dekani. Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në note. Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Gjatë zhvillimit të provimit, ku është i pranishëm komisioni i miratuar nga Dekani, nuk lejohet ndërrimi i tezës. (Anex_I_3_Rregullore e KUQ; Anex_II_1_Rregullore e FE; Anex_III_1_Rregullore e programit të studimit Bsc në MB; Anex_III_2_4_Syllabuset e _BCS_MB)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Pa përmbushur</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.6

**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i

Nga verifikimet u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve



njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	të studentit gjatë gjithë semestrit dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e FE dhe rregulloren e DMB. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë: Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit dhe vlerësimi përfundimtar. Këto programe miratohen çdo vit nga përgjegjësi i departamentit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për zbatimin e këtij kriteri, deri më tani korrigjimet bëhen nga pedagogët dhe janë transparente tek studentët pikët dhe vlerësimi. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Përgjegjësi i departamentit (koordinatori i programit të studimit) dhe komisionet e lëndëve janë përgjegjëse për krijimin e komisioneve të provimit. Në përbërjen e tij ka së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit, ndërsa antari tjetër nga i cili buron lënda/moduli, dhe që është përcaktuar në syllabus, apo ka të njëjtin profil ose të përafert. Komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Në KUQ, FE dhe DMB vlerësimi i njohurive dhe dijeve me shkrim behen në menyre anonime. Ky procesi i zhvillimit të provimit ndiqet nga sekretaria mësimore. Fletoret, apo fletët e provimit, pasi korigjohen hapen po nga sekretaria që i ka sekretuar dhe pedagogu njeh pikët për secilin student. (Anex_II_1_Rregullore e FE; Anex_III_1_Rregullore e programit të studimit Bsc në MB; Anex_II_5_Rregullore e Departamentit MB)
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Titullarët dhe asistentët e lëndëve dhe moduleve të këtij programi studimi i japin informacion dhe i orientojnë studentët mbi të gjithë elementët e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale. Nga takimi me studentët u informuam që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, foto, video në orët e fundit të seminareve). Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre referuese (prezantuese).
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Në DMB komisionet e provimit përbëhen nga të paktën dy pjestarë të stafit akademik të miratuar sipas përcaktimit të rregulloreve. Hartimi i tezave të reja bëhet për çdo sezon provimi si dhe të paktën në dy variante. Personelit akademik që ndjek procesin e provimit u ndalohej hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të personelit të KUQ, me përjashtim të drejtuesit të departamentit apo personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori/Rektorati



	<p>për të kryer kontrollin. Studentëve nuk u lejohej të futen në provim nëse nuk disponon një nga mjetet e identifikimit si librezën e studentit/ kartën e identitetit si dhe nuk lejohej mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Studentët që në provim përdorin forma e mjete të palejueshme përjashtohet nga provimi. Përsa i përket temave të diplomave udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe mënyrën e referimit të saj. Është rritur kërkesa ndaj studentëve që mbrojnë temat e diplomave për të shmangur plagjiaturën.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë proçesit të kontrollit stafi shënon pikët për çdo ushtrim si dhe tregohet i kujdesshëm të përfshijë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/modulit dhe kontrollohen nga përgjegjësi i departamentit. Rezultatet e provimit hidhen proceverbale në sistem nga komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 8 ditëve kalendrike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shpalljes së rezultateve dhe hedhjes së tyre në sistem, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit dhe në sistem brenda dy ditëve. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi administrative komisionin e provimit. Provimet me shkrim të studentëve ruhen nga pedagogu i modulit për një periudhë 6 (gjashtë) mujore pas përfundimit të sezonit të provimeve.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankimohej në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimeve ose nuk është dakort me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 24 orëve. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjësin e departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësin e Departamentit, që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



**Standardi III.7**

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lende nepermjet te cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit. Modulet janë të ndara në mënyrë të balancuar të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. Kjo garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre.</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës. Në përfundim të çdo moduli studentët fitojnë një grup kompetencash dhe aftësish të ndara në 3 grupe: a) kompetenca instrumentale, b) kompetenca sistemike, dhe c) kompetenca komunikuese.</p> <p>Në syllabuset e detajuara janë përcaktuar specifikisht kompetencat specifike sipas këtyre grupeve që fitojnë studentët në secilin modul të programit të studimit.</p> <p>Në fund të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Njëkohësisht, merret edhe feedback nga ana e studenteve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim. Gjithashtu, ata orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në kete program studimi organizohen orë të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit Bsc në MB, I ëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentet me aftësi për tju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit në Bsc "Menaxhim Biznesi" dhe plani mësimor, i lë në semestrin e 6-të tri javë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo ju jep mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit në Bsc në "Menaxhim Biznesi" gjatë procesit mësimor, u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojnë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të</p>



	<p>sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut. Ata nëpërmjet bashkëpunimit e punës në grup mundësojnë zhvillimin e një detyre ose mini projekti kërkimor në mënyrë individuale apo në grup, zbatojnë në praktikë dijet dhe instrumentat e fituara në lëndët apo modulet gjatë trajtimit teorik, rrisin frymën e punës në grup dhe do jenë në gjendje të analizojë rezultate dhe të sintetizojë konkluzione apo dhe të ofrojë rekomandime për çështje dhe problematika të caktuara praktikisht. Detyrat e kursit shërbejnë si një bazë praktike shumë e rëndësishme për studentët për tu familjarizuar me punën kërkimore dhe të përgatitjes së temës së diplomës.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Nga vizita dhe takimi me studentet, konstatoam se personeli akademik krijon një klimë të përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punë kërkimore-shkencore. Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. Në këto studime që ata kryejnë, mbështeten gjërësisht nga stafi akademik i departamentit. Vitin e kaluar nga FE kanë marrë pjesë student të FE në konferencën shkencore të zhvilluar në bashkëpunim me Albanian University, LaSapienza etj. dhe janë paraqitur edhe me punime shkencore rezultat i bashkëpunimit të tyre me personelin akademik dhe mbështetjen që ata u kanë dhënë në këtë drejtim.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Departamenti ka mbështetur dhe po mbështet studentët e vitit të fundit Bachelor kur përgatisin tema diplome. Temat që u mbajten në konferencën shkencore në dhjetor 2018 shërbejnë si bazë për përgatitjen e diplomave për përmbylljen e ciklit të parë të studimeve për studentët me rezultate të larta. Kolegji i mbështeti pedagog e student, duke i sponsorizuar shpenzimet e pjesëmarrjes dhe të botimit të temave të konferencës u nga Institucioni. Veprimtaritë kërkimore shkencore dhe konferencat që do të organizojnë studentët janë planifikuar që të mbështeten e të sponsorizohen të gjitha nga Kolegji. <i>Por u evidentua që deri tani nuk është bërë asnjë e tillë dhe studentët nuk kishin informacion</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurur format e mësimdhënies me institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi të ndërsjelltë jo vetëm për pedagogët, por edhe për mobilitetin e studentëve. Nga takimi në institucion na u komunikua që po punohej për të realizimin e marrëveshjeve me institucionet e tjera jashtë vendit sidomos për mobilitetin e studentëve, por deri tani nuk ka asnjë të tillë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	



<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Nga verifikimi i GVJ diplomimi studentëve në këtë program bëhet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me mbrojtjen e një punimi diploma, të cilat publikoheshin në faqen e internetit të KUQ si dhe në standat e Kolegjit. Këto kritere janë përcaktuar në rregulloren FE. (Anex I 3 Rregullore e KUQ; Anex II 1 Rregullore FE; Anex II 17 Kërkesat për përgatitjen e punimit të Diplomës)
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukture përgjegjëse e këtij program është Departamenti Menaxhim Biznesi, i cili sipas rregullores dhe atyre që konstatuam i bën të ditur studentëve kriteret e diplomimit. Për këtë angazhohej stafi i brendshëm por dhe specialiste të kualifikuara nga universitete apo institucione të tjera kërkimore shkencore. Sipas kritereve studenti depoziton kërkesën pranë departamentit për tu listuar në listën e studentëve për mbrojtje diplome. Në kërkesë ai parashtron temën e diplomës brenda fushës së studimit dhe propozon pedagogun udhëheqës. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat e studentëve, mbi bazën e të cilave harton listën e studentëve që plotësojnë kriteret për të përgatitur një punim diplome dhe udhëheqësin dhe ja paraqet për miratim Dekanit të FE-së. Drejtuesit e temave të diplomës për të gjithë studentët e listuar që plotësojnë kriteret, miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Format i paraqitjes së punimit të diplomës është përcaktuar në rregulloren e departamentit. Studentët të cilët nuk plotësojnë kriteret për mbrojtjen me punim diplome apo nuk kanë dëshirë zhvillojnë punim diplome zhvillojnë provim të përgjithshëm formimi. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohet nga stafi akademik i departamentit dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i FE-së. I gjithë informacioni publikohet në website të kolegjit. (Anex I 3 Rregullore e KUQ; Anex II 1 Rregullore FE; Anex II 5 Rregullore departamentit MB; Anex II 17 Kërkesat për përgatitjen e punimit të Diplomës)
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohurisë dhe gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ konstatoi se provimi final bazohet në testimin e njohurive të 3 viteve duke përfshirë lëndët dhe modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Komisioni ndjek procedurat dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e FE. (Anex I 3 Rregullore e KUQ; Anex II 1 Rregullore FE; Anex II 5 Rregullore departamentit MB; Anex II 17 Kërkesat për përgatitjen e punimit të Diplomës)
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Nga takimet me studentët dhe stafin, GVJ konstatoi që udhëheqësi i punimit të diplomës orienton dhe ndihmon studentin për përgatitjen e temës së diplomës. Sepse përgatisin programin e punës së studentit, afatet gjatë të cilave ndihmohet dhe kontrollon punën e bërë sipas programit të miratuar. Personeli akademik i departamentit ndihmon studentët me sqarime në lidhje me programin e provimit, sipas fushave që ata mbulojnë. (Anex I 3 Rregullore e KUQ; Anex II 1 Rregullore FE;



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ vlerësoi nga takimet se studentët e programit të studimit në Bsc "Menaxhim Biznesi", përdorin literaturën e bibliotekës, e cila ka nevojë të pajiset me tituj librash të fushës, shfrytëzimin e internetit për kryerjen e studimit. Labororet e teknologjisë së informacionit kanë mjedise të mjaftueshme dhe kompjutera në të cilat studentët e këtij program studimi, i përdorin për përgatitjen e temave të diplomave. Anex_I_3_Rregullore e KUQ; Anex_II_1_Rregullore FE; Anex_II_5_Rregullore departamentit MB; Anex_I_11_7_Statistikë për mjediset e KUQ)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga verifikimet dhe vizita në kolegji u konstatua se pedagogu udhëheqës i temës, në ato raste kur deshiron studentin të mbrojë një punim diploma, përgatit metodikën e studimit për realizimin e temës së diplomës dhe mbi bazën e saj organizohet e gjithë puna kërkimore që duhet të kryejë student etj duke i dhënë atij të gjithë asistencën e nevojshme për realizimin e punimit të diplomës nga fillimi i kërkimit deri në shkrimin e raportit të punimit, duke garantuar në këtë mënyrë cilësinë e tij. Gjithashtu, udhëheqësi në përfundim të punimit harton një raport të shkurtër me anë të të cilit e miraton atë, ose në rastet kur studentin nuk i është përmbajtur kriterëve dhe udhëzimeve të tij nuk e miraton, ose i ben vërejtjet për përmirësim. Këtë raport ai ja paraqet komisionin së bashku me punimin e temës së diplomës. (Anex_I_3_Rregullore e KUQ; Anex_II_1_Rregullore FE; Anex_II_5_Rregullore departamentit MB; Anex_II_17_Kërkesat për përgatitjen e punimit të Diplomës)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ duke marrë parasysh informacionet e grumbulluara gjatë vizites, dhe rregullores së FE, konstatoi se për studentët që japin provim formimi, teza e provimit përgatitet nga departamenti Menaxhim Biznesi dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Evidentuar nga dokumentat por dhe nga komunikimi në institucion, si me studentet dhe me pedagogët se koha e nevojshme për përgatitjen e studentit në provim është 60 min, nota llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit dhe i bëhet e ditur studentit pas provimit. Nëse tre nga antarët e komisionit bëjnë vlerësim negativ, atëherë studentin vlerësohet negativisht. Për studentët që mbrojnë temën e diplomës nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit dhe i komunikohet studentit ditën e mbrojtjes përpara komisionit. Por, nëqoftë se tre nga antarët e komisionit japin vlerësime negative, atëherë provimi i formimit vlerësohet negativisht. (Anex_I_3_Rregullore e KUQ; Anex_II_1_Rregullore FE; Anex_II_5_Rregullore departamentit MB)</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të këtij program studimi studentet do të pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës. Këto janë përcaktuar dhe miratuar nga MASR.  Anex_I_3_Rregullore e KUQ; Anex_II_1_Rregullore FE; Anex_III_3_2_Diploma "Qiriazit" bachelor FE_MB Anex_III_3_2_1_Model suplement diplome "Qiriazit" Bsc FE_MB)</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentin i vihet në</p>	<p>Kopja e plotë e programit të zhvilluar të studimeve u jepet vetëm studenteve që depozitonin një kërkesë dhe jo të gjithëve.</p>



dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	(Anex_I_3_Rregullore e KUQ; Anex_II_1_Rregullore FE; Anex_1_9_Rregullore e sekretarisë mësimore)			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	U konstatua nga GVJ qe dokumentacioni për studentët ne vite nuk ishte I plote dhe kishte shume mangesi ne dokumentacionin e studenteve te viteve te meparshme .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përlshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Personeli akademik propozohet nga Departamenti I menaxhimit te Biznesit, dhe ne bashkepunim me departamentin e Financës dhe departamente te Fakultetit të Drejtësisë per lende te natyres se perbashket. Miratimi behet nga dekani i Fakultetit Ekonomik dhe Reaktori i Kolegjit. Zyra e burimeve njerëzore angazhohet ne mbledhjen, ruajtjen dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të përlshirë dhe mekontratë. Nje kopje e CV-së të gjithë pedagogëve që japin mësim në program ruhet edhe në departament. <i>Për arsye të numrit të vogël të studentëve nuk ka personel ndihmësmësimor dhe administrativ në bazë Fakulteti.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ka procedura për rekrutimin e personelit akademik te cilat janë te reflektuara ne Rregulloren e programit dhe ate te Fakultetit. Departamenti ben planifikimin për staf akademik, kjo e bazuar dhene numrin e studentëve të planifikuar, dhe pasi miratohen nga Fakulteti shpallen në faqen e internetit të Kolegjit dhe mediat audiovizive e shkruara. Administratori i Kolegjit ka është ngritur një komision për vlerësimin e kandidaturave, I cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, fakultetit, departamentit dhe titullarit të lëndës që do japin mësim. <i>Miratimi i tyre bëhet në fillim të muajit tetor, në përputhje me numrin</i>



	<i>e studentëve të regjistruar faktikisht.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullore dhe i bën ato publike.	Për rekrutimin e personelit ndihmës, me karakter administrativ janë zbatuar kritere të posaçme e specifike, sipas vendit të punës bazuar në aktet rregullore të Kolegjit. <i>Për arsye të numrit të vogël të studentëve nuk ka personel ndihmës mësimor dhe administrativ në bazë Fakulteti.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedurat e rekrutimit të personelit akademik, kriteret e përgjithshme dhe specifike, hartohen nga departamenti I menaxhimit të biznesit dhe bëhen publike. KUQ, për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, ndan kriteret për vlerësimet të kandidatëve për staf akademik në: <i>A. Krite elimuese,</i> <i>B. Krite preferuese dhe të vlerësuara (me pikë)</i> <i>C. Krite plotësuese (me pikë)</i> <i>D. Intervistë gojore (me pikë)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Infrastruktura në KUQ krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Institucioni disponon salla leksionesh dhe auditoro për seminare, të pajisura me infrastrukturen e nevojshme mesimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerezore, Financa, Biblioteka, etj janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturen e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre. Institucioni ofron gjithashtu ambiente shlodhese si bar/restorant, të cilat janë në dispozicion të stafit dhe studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni ben përpjekje për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të personelit të programit, nëpërmjet organizimit të leksioneve të hapura, konferencave shkencore dhe trajnimeve për përdorimin e metodave bashkëkohore të mesimdhënieve. Këto aktivitete pasqyrohen gjithashtu edhe në web-faqen e institucionit. <i>Kolegji ka organizuar në bashkëpunim me Albanian University dhe IAL të tjerë brendavenditsi dhe La Sapienza Itali dy Konferenca Shkencore dhe shpezimet si dhe botimet e artikujve të mbajtur nga</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënieve e	



<p>përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p><i>stafiakademik janë sponsorizuar nga Bordi i Administrimit. Me Akademinë e Shkencave është zhvilluar aktiviteti për bashkët për problem të Etikës ku u referua nga Prof.Dr. Agim Binaj dhe është planikuarnjë tjetër në Qershor të këtij viti për problemet fiskale. Janë mbajtur leksione të hapura nga pedagog të ardhura nga SHBA, Gazetare nga Anglia, Opus Deinga Italia etj.</i></p> <p>Duke filluar nga ky vit akademik, KUQ ka bere active nje platforme online "E-learning", ku secili professor ka faqen e tij te cilen e pasuron me leksione dhe material te tjera te nevojshme per modulet qe ofron. Pedagogu I informatikes I cili eshte pergjegjes dhe per mirembajtjen e kesaj platforme komunikimi, trajnon dhe asiston personelin dhe studentet per nje perdorim sa me eficient te saj.</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Detyrat e stafit akademik dhe ndihmës janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit, Fakultetit Ekonomik dhe Departamentit të Menaxhimit, si njësi bazë që përgjigjet direct për përmbushjen e objektivave të programit të ciklit të parë të studimeve Bsc në "Menaxhim Biznesi". Ngarkesa mësimore dhe shpërndarja e saj dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 902 742 969">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="742 902 949 969">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="949 902 1157 969">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1157 902 1364 969">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td align="center"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>KUQ, si nje institucion me numer te vogel studentesh. 270 ne total dhe 63 studente ne programin Bsc ne "Menaxhim Biznesi", e permbush kete kriter nga pikepamja e siperfaqes dhe mjedisve te nevojshme dhe te përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p><i>Mjediset e godinave plotësojnë normativat eknike të ndriçimit natyral.</i></p> <p><i>Të gjitha mjediset e godinave kanë sisteme portativetë fikjes sëzjarrit, paketen endihmessë shpejtë.Në godinë ka të instaluar dy motogjenerator me paketa automatike, për furnizimin me energji elektrike, në rast ndërprerjeje të furnizimit nga rrjeti qëndror.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë</p>	<p>Mjediset mesimore ne KUQ jane te pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, te tilla si tabela whiteboard dhe smartboard, wireless, te cilat mundësojne zhvillimin e mësimin në kushte bashkekohore. Dy laboratorët të cilët janë në funksion të zbatimit tëkëtij programi studimi, janë të kompletuar jo vetem me</p>



realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	programet standarte por edhe specifikesi p.sh <i>matlab, financa5</i> në funksione të lëndëve të veçanta si elektronika ,kontabiliteti si edhe shumë orë seminar të matematikës dhe statistikës.			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Sugjerohet që të perdoren edhe programe specifike ne fushen e menaxhimit te biznesit p.sh Microsoft Project ne lenden e Menaxhimit te Projekteve. Ne kete menyre do te rriteshin aftesite e studenteve ne fushen e biznesit ne te cilen diplomohen.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Insitucioni disponon nje liste marreveshjesh me institucione dhe biznese per kryerjen e praktikave profesionale prane tyre. Rregullorja e praktikës profesionale përcakton detyrat e departamentit, stafit akademik dhe studentëve (Anex_II_8). KUQ ka ambiente studimi ne Biblioteke dhe kancelari ku studentet mund te studiojne dhe kryejne detyrat e kursit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Kapaciteti që ka biblioteka garanton deri diku mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Gjatë vizitës në KUQ na u sqarua se punonjësja e bibliotekës mendohej të akomodonte studentët duke alternuar oraret ndërmjet programeve të studimit. <i>Në katin e pare të godinës, në kancelari, që sherben dhe si librari ndodhet një sallë leximi si pjesë e bibliotekës kryesore që është në katin e tretë.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë	KUQ disponon nje Biblioteke e cilaka një fond librash,në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj,duke perfshire edhe tituj te fushës së programit të studimit Bsc në “MenaxhimBiznesi”. Krahas literaturës



<p>ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>fizike, institucioni perdor material ndihmëse dhe informuese për studentët si dhe forma e leksioneve në ppt. të cilat i vihen në dispozicion studenteve nëpërmjet faqes online te secilit prej pedagogëve te programit te studimit.</p> <p>Sugjerohet që institucioni të shtojë përpjekjet për të siguruar titujt fizikë të teksteve bazë dhe literaturës shtesë me botime të viteve të fundit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Momentalisht bibliotekat on-line nuk aplikohet në KUQ. Por, institucioni po punon për të siguruar bibliotekën online që tu sigurojë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e saj pa pagesë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Aktualisht Biblioteka nuk ka programe kompjuterike, por studentet mund te gjejne listen e vendndodhjes se librave te bibliotekes nepermjet faqes se internetit te kolegjit, duke perdorur labororet e informatikes.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>KUQ ben përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fonditegzistues në mbështetje të programit, duke perfituar edhe nga donacionet e pedagogëve me botimet e tyre.</p> <p><i>Këtë vit ju shtuan dhe 740 librae shumë revista nga Akademia e Shkencave në bazë të një marrëveshje bashkëpunimi dhe pritet të sigurohet nga ajo dhe biblioteka on-line.</i></p> <p>Sugjerohet që Institucioni të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka I vihet në dispozicion studentëve gjate orareve publike e Hënë- e Premte nga ora 8.00-16.00. Ky orar sipas vizitës në institucion, është përcaktuar me qëllim që studentët të kenë mundësi ta shfrytëzojnë atë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit, si dhe për të përballuar numrin e studentëve të interesuar me kapacitetin e bibliotekës.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;"><b>X</b></p>				

<p><b>Standardi IV.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të</p>	<p>Institucioni ka zyra mbështetese te cilat mundesojne administrimin dhe shpërndarjen e informacionit dhe <i>respektojnë njëkohësisht</i></p>



<p>cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p><i>konfidencialitetin për çështje të caktuara (Anex I 7.2), te tilla si Sekretaria Mësimore, Zyra e Mardhënieve me Jashtë, e Pranimeve dhe e Këshillimit të Karrierës. Keto zyra janë hapur pas heqjes së pezullimit institucional, në vitin 2016, dhe ofrojnë informacion kryesisht për institucionin që nga viti 2016. Po ashtu faqja zyrtare e internetit <a href="http://www.qiriazi.edu.al">www.qiriazi.edu.al</a> ofron informacione që nga kjo periudhë për studentet dhe stafin akademik-administrativ.</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrative dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit menaxhohen nga Zyra e Burimeve Njerezore. Sugjerohet që kjo zyre të plotësojë dhe firmosë dokumentacionin për PAE dhe PAK të angazhuar në program.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>KUQ siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Sekretaria mesimore ofron informacion të specifikuar mbi programin e studimit, datat e provimeve dhe notat të personalizuar për çdo student.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Platforma elektronike lehtëson komunikim interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve dhe studentëve në kohë reale.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit si dhe numri i vogël i pedagogëve me të cilët janë në kontakt çdo ditë organet drejtuese të institucionit siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>KUQ publikon në shqip dhe anglisht, në faqen e tij të internetit informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



**Standardi IV.6**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Rregullat për shpërndarjen e burimeve dhe të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij përcaktohen nga Bordi i Administrimit, i cili është organi që mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit.</p> <p>Sugjerohet të hartohet një plan-buxhet i detajuar me kostot për student për çdo vit të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Burimet financiare të institucionit mbështeten në kapitalin vetjak dhe të ardhurat nga ushtrimi i veprimtarive të tij. KUQ nuk ka përfituar fonde apo donacione të tjera nga të tretët.</p> <p><i>Institucioni dorzon në QKR bilancin vjetor, sipasdis pozitive ligjore ku janë të saktësuara të ardhurat dhe shpenzimet vjetore. Këtë vit akademik me kërkesën e departamenteve dhe në mbështetje të programeve të studimit u ngriten tre laboratore të reja (informatikës, elektronikës dhe kimi-teknologjisë).</i></p> <p>Sugjerohet të hartohet një plan-buxhet i detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond i vecantë për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/aksesin në bibliotekat on-line.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe elektivititetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion rezulton se Institucioni kryen çdo vit auditim të brendshëm të jashtëm. Na u referua se rezultatet e auditimit i bëhen të ditura Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik për të përcaktuar masat e nevojshme në vitin akademik që duhen për çdo program studimi.</p> <p><i>Për këtë KUQ ka akt marrveshje me një firmë auditimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Ky është cikli i parë i studimeve Bsc në Menaxhim Biznesi, i cili perfundon këtë vit akademik.</p> <p>Në mbyllje të vitit akademik, Institucioni do dokumentojë raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe do planifikojë ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka</p>	<p>Sipas praktikave të brendshme të institucionit, regjistrimet kontabel dhe pasqyrat financiare përgatiten me baze legjislativore në fuqi, diskutohen dhe se fundmi miratohen në strukturat e kolegjit (Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit). Institucioni ka vënë në</p>




kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	dispozicion informacionin lidhur me planin financiar dhe pasqyrat financiare që I perkasin vitit 2017-2018. Mangësi vërehet në shtrirjen e planit financiar për vitet akademike në vijim sipas parashikimeve të institucionit si dhe përlogaritja e kostos për student. Burimi kryesor i të ardhurave për institucionin ngelet kapitali vetjak dhe veprimtaria kryesore. Sugjerohet të hartohet një plan-buxhet i detajuar me të ardhurat dhe kostot për student për çdo vit të programit të studimit. Rekomandohet që të shtohen përpjekjet për të përthithur fonde nga projekte dhe grante në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria financiare në të ardhmen.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Asnjë përbushje</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Asnjë përbushje</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	KUQ ka hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloren e institucionit, rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e Departamentit të Menaxhim Biznesit dhe rregulloren e programit të studimit të cilat specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga program i studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi nga vizita në institucion shqyrtimi i dokumentacionit dhe sidomos intervistat me studentët e programit, se politikat dhe procedurat që ndjek KUQ nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. (Ref. Kreu II, neni 6 I “Rregullore Bsc Menaxhim Biznesi”)
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e kolegjit, të FE, të Departamentit të	Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e kolegjit, të FE, të Departamentit të





mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Menaxhim Biznesit dhe të programit të studimit. Në këtë program studimi ka patur edhe largime edhe transferime studentësh. Nga takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me jashtë dhe Pranimit dhe këshillimit për karrierë u konfirmua që institucioni përdorte ditet e karrierës për të bërë publike procedurat dhe kriteret e pranimit. <i>Politikat dhe procedurat bëhen publike përmes faqes së internetit të KUQ, sipas RVB dhe vizitave në institucion. Por nga një verifikim, nuk kishte asnjë informacion në këtë faqe.</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Vizita në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Aneksi I-14) konfirmojnë që KUQ miraton në fillim të vitit akademik kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor, bazuar në legjislationin në fuqi dhe rregulloret përkatëse.		
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e përgjithshme të pranimit të studentëve të përcaktuara në rregulloret përkatëse dhe ato specifike të miratuara në fillim të çdo viti, hartohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë së arsimit. Sipas nenit 6 të Rregullores së programit të studimit, për tu pranuar në programin e studimit të ciklit të parë bachelor në "Menaxhim Biznesi" kandidati duhet të ketë përfunduar ciklin e arsimit të mesëm dhe provimet e detyrueshme të Maturës Shtetërore, si dhe të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të KM. Në këtë program studimi lejohet të ndjekin studime edhe kandidatë që kanë një diplomë tjetër të marrë nga një institucion jashtë vendit, por të njohur nga MAS, si dhe kandidatë që kanë një diplomë universitare, brenda ose jashtë Shqipërisë, dhe që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi.		
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara çdo fillimi viti akademik, sipas informacionit që GVJ morri gjatë vizitës në institucion, KUQ njihet e interesuara me programin e studimit që ofron dhe kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për çdo program. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet ditëve të karrierës, vizitave në gjimnaze apo vizitave që kanë bërë maturanët në ambientet e kolegjit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në	Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e kolegjit, FE, Departamentit të Menaxhim Biznesit dhe rregulloren e programit të studimit. Nëpërmjet "Zyrës së Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me jashtë dhe Pranimit dhe këshillimit për karrierë" rregulloret u vihen në dispozicion

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



tjetrin.	studentëve dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet që kanë studentët me përgjegjësin e departamentit. Neni 27 i rregullores së KUQ përcakton kriteret e kalimit të studentëve në vitin pasardhës. Që student i vitit të parë të kalojë në vitin e dytë duhet të ketë marrë të paktën 30 kredite, ndërsa për të kaluar në vitin e tretë duhet të ketë fituar të paktën 80 kredite.								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë "Menaxhim Biznesi", neni 22, përcakton procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të kolegjit në shkolla të tjera. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit. Studentëve u vihet në dispozicion rregullorja, nëpërmjet të cilës ata njihen me kriteret e transferimeve.								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në programet e cdo lënde. Meqënëse programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mësimi, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në cdo lëndë.								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e kolegjit, rregulloren e FE, rregulloren e Departamentit të Menaxhim Biznesit dhe të programit përkatës të studimit. Kolegji ka hartuar edhe një udhëzues mbi punimin e diplomës që u bëhet i njohur studentëve nga takimet me përgjegjësin e departamentit dhe pedagogët udhëheqës të tyre.								
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në fillim të cdo viti akademik kolegji organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky kolegji. Këto takime të hapura janë zhvilluar edhe në shkolla të mesme por edhe duke i fuar maturantët në ambientet e kolegjit. Gjithashtu kolegji përgatit udhëzime, fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi organigramën e Fakultetit, dhe strukturën e programit të studimit



	afishohet në stendat e kolegjit si edhe një informacion më pak i detajuar shfaqen në faqen e internetit të KUQ.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës. Një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambjentet e institucionit. Sipas RVB në faqen e internetit të KUQ publikohen planet mësimore, por nga verifikimi i kryer, informacioni që ofrohet në faqen e internetit është shumë i pakët.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet "Zyrës së Burimeve Njerëzore, Marrëdhënive me jashtë dhe Pranimit dhe këshillimit për karrierë". Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me organizata publike dhe të biznesit.			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e Fakultetit të Ekonomisë, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e kolegjit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leskioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj.			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Gjatë intervistës me stafin akademik pro edhe grupin e punës na u referua se cdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratoët e teknologjisë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Brezi i parë i studentëve diplomohen këtë vit akademik. Por për programet e tjera të studimit sipas RVB (për vitin 2017-2018), sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe	Sekretaria mësimore, nëpërmjet rregjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga program i studimit për cdo vit akademik. Një përmbledhse e numrit të studentëve është vënë në



largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	dispozicion nga kolegji nëpërmjet dokumentit në Aneksin II_1_14. Rezultoni mospërputhje e informacionit të marrë gjatë vizitës në sekretarinë mësimore (dokumenti "shënime gjatë vizitës") dhe dokumentit në Aneksin II_1_14.		
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria mësimore regjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre.		
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregullore e sekretarisë mësimore.		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve. <i>Vitin e kaluar akademik (2017-2018) pati diplomime për të cilët disponohen të dhëna të plota sipër notat mesatare në hyrje dhe dalje si dhe punësimin e tyre.</i> Ndërkohë që nuk është llogaritur ende mesatarja e notave në përfundim të studimeve (meqënëse nuk ka mbaruar ende viti akademik).		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Nëpërmjet Statutit të KUQ (neni 39), rregullores së FE (neni 99) dhe rregullores së Departamentit të Menaxhim Biznesit (neni 65) institucioni parashikon angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese (si Senati i KUQ dhe NJSBC) sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentet e vëna në dispozicion nga kolegji, GVJ konfirmoi se studentët ishin realisht të përfshirë në këshillim dhe vendimarrje. Studentët kishin përfaqësuesin e tyre si në Senatin e kolegjit, në këshillin e etikës (neni nr. 4 i Rregullores së Këshillit të Etikës) edhe në zyrën e NJBSC. Sipas Statutit ata kanë formuar edhe Këshillin studentor. Në RVB shkruhet për krijimin e Forumit studentor, organ i cili nuk parashikohet në dokumentet e



	përmendur më sipër. Nga vizita në institucion, në takimet me grupin e punës dhe studentët, u nënkuptua se duhet të ishte një "lapsus" përdorimi i emërtimit Forum në vend të "Këshill".			
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	GVJ konstatoi se programet e studimi janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve. Statuti i KUQ dhe rregulloret përkatëse parashikojnë procedurë joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtëpërdrejtë në këtë drejtim shërben edhe pyetsori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri. GVJ konstatoi se pyetjet në pyetsor lidheshin më shumë me performancën e pedagogut se sa me programin e studimit dhe në fakt nuk përbën një burim informacioni në këtë drejtim.			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregullorja e FE (neni 67), rregullorja e Departamentit të Menaxhim Biznesit (neni 35) dhe rregullorja e programit të studimit Bsc në "Menaxhim Biznesi" (neni 18) mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimit studentëve si dhe nëpërmjet përcaktimit të procedurës që ndiqen nga institucioni në këtë rast.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	KUQ ka ngritur "Zyrën e Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me jashtë dhe Pranimit dhe këshillimit për karrierë", e cila kryen disa funksione, përfshirë edhe atë të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve. Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të veta IAL-ve. Nga vizita në institucion, GVJ iu confirmua se është një zyrë që



	<p>kryen funksionet e të tre zyrave, për shkak të numrit relativisht të ulët të studentëve që ka kolegji.</p> <p>Sugjerohet këto funksione të kryhen nga zyra të vecanta, për të realizuar prishmëritë që KUQ ka për të ardhmen.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimarrëse, këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies, studentët kanë mundësi që të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Të drejtat e studentëve në këtë drejtim, përveç dokumenteve të sipërpërmendur, përcaktohen edhe në Rregulloren e Zyrës për Marrëdhëniet me Jashtë, e Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë. Kjo rregullore e vënë në dispozicion në DVV, nuk është e firmosur dhe pavarësisht nga emërtimit (për të cilën gjatë vizitës në institucion u komunikua që përfshinte edhe burimet njerëzore) bën fjalë vetëm për funksionet e zyrës së këshillimit dhe karrierës.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>KUQ ka hartuar një rregullore për organizimin dhe funksionimin e Zyrës për Marrëdhëniet me Jashtë, e Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë dhe ka ngritur edhe zyrën e Këshillimit të Karrierës. Neni 2 i kësaj rregullore përcakton misionin dhe qëllimet e Zyrës së këshillimit për karrierë për ti shërbeyer nevojave për zhvillim të karrierës së studentëve, duke siguruar cilësi të lartë dhe shërbime të ndryshme nëpërmjet këshillimit, konsultimeve dhe partneriteteve të qëndrueshme, që nga organizimi i i përvitshëm i prezantimit të programeve të studimeve në ambjentet e Fakulteteve, informin e studentëve, lidhur me mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, dhe mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sipas rregullores së Zyrës për Marrëdhëniet me Jashtë, e Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë, një nga detyrat e kësaj zyrë është edhe përpilimi, plotësimi dhe përditësimi i Skedës së Punësimit për Studentët e nivelit Bachelor, Master Profesional dhe Master Shkencore. Nga vizita në institucion, GVJ iu konfirmua se kolegji ende nuk ka një zyrë Alumni, për shkak të pezullimit të programeve të studimit dhe numrit të pakët të studentëve të diplomuar deri tani. Ky program studimi nuk ka ende të diplomuar.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



## VL.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>KUQ në përmbushje të kërkesave të ligjit dhe të misionit të vet strategjik ka krijuar struktura dhe ka hartuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie. Këtë e ka paraqitur në Statut, (Aneks I_1, neni 43), në rregulloren e Departamentit (Aneks II_5), si dhe në objektivat e programit (Aneks III_1). Po ashtu KUQ ka krijuar edhe rregulloren e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohen të gjitha mekanizmat e arritjes së nivelit të dëshiruar të cilësisë. Njësia përkatëse është në varësi të Senatit Akademik, cka i siguron pavarësinë në punën dhe kompetencat e saj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sistemi operativ i sigurimit të cilësisë sic përshkruhet në rregulloren përkatëse përbëhet nga manuali i sigurimit të cilësisë, procedurat, udhëzimet dhe format e përdorimit dhe standartet (pika 1.4 e rregullores së cilësisë). Institucioni e ka të ngritur këtë sistem dhe e monitoron nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Në këtë Njësi përfshihen personel i brendshëm i Universitetit; nuk ka anëtarë të jashtëm të pavarur dhe as përfaqësues të studentëve. Po ashtu anëtarët e saj janë mbajtës të disa funksioneve të tjera pedagogjike apo administrative, cka e vë në diskutim funksionin e saj të pavarur, sic e pasqyron organograma.</p> <p>Sugjerohet të ketëpërfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Instrumentat që përdor institucioni për vlerësimin e brendshëm janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Anketimi i studentëve me anë të një pyetësori</li> <li>2. Mbledhjet e hapura</li> <li>3. Vlerësimi i pedagogut në orën mësimore.</li> </ol> <p>Institucioni ka përfshirë në raportin vjetor të cilësisëmasat e ndërmara në lidhje me raportet e ekspertëve të jashtëm dhe rekomandimet e tyre si dhe ka hartuar një plan veprimi për detyrat që ASCAL ka lënë për përmbushje. Ajo që nevojitet të shënohet është fakti i angazhimit i po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra.</p> <p>Gjithashtu sugjerohet që mbledhjet e hapura (nese jane te karakterit te matjes se performances) te kene nje natyre tjeter per te respektuar privatesine e stafit akademik, integritetin dhe personalitetin e tyre. Raporti i vleresimit te pedagogut ne oren mesimore duket me teper si nje formular vleresimi i performances kundrejt te objektiveve vjetrore, sesa si performance ne oren e mesimit. Gjithashtu nuk ka nje</p>



	<p>hapesire per komente nga ana e te vleresuarit. Ne raportin vjetor te NJSBC nuk ka nje analize ne lidhje me keto instrumenta te perdorura gjate vitit akademik, konkluzionet e nxjerra dhe plan aksioni per t'i vendosur ne funksion.</p> <p>Sugjerohet pavarësia e stafit në hallkat e sigurimit të cilësisë, rishikimi i instrumentave per te garantuar perdorshmerine e tyre dhe përfshirja e perdorimit te instrumentave ne analizen vjetore te Departamentit dhe NJSBC.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Instrumentat e përmendur më sipër përdoren në mënyrë periodike nga institucioni për vlerësimin e brendshëm. Këto instrumenta relativisht të rinj në përdorim të institucionit përfshihen edhe në raportin dhe manualin vjetor të Njesisë së Sigurimit të Cilësisë. Nuk ka pasur ndonjë shembull që këto mekanizma të kenë shënuar për të vërtetuar funksionin e tyre, për shkak se janë relativisht te reja në praktikë (vlerësimet nga studentët janë bërë në pranverë 2019.)</p> <p>Përvec përdorimit të mekanizmave sigurimi i cilësisë shtrihet edhe në rekrutimin e stafit, organizimin e programit mësimor, zhvillimin e programit dhe kërkimin. NJSBC në çdo rast është prezent për të siguruar cilësinë dhe për të krijuar një kulturë në rang institucional. Ajo që nevojitet të shënohet është fakti në angazhimin e po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra.</p> <p>Sugjerohet pavarësia e stafit në hallkat e sigurimit të cilësisë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Asnjë përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

<p><b>Standardi VI.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Njesia baze per menaxhimin e programit te studimit eshte Departamenti (Rregullore e Departamentit te Menaxhim Biznesit)(Aneks II_5). Kjo njesi baze se bashku me NJSBC kryen mbikqyrjen, rishikimin dhe monitorimin e programeve. Sic permendet edhe tek Raporti vjetor NJSBC pika II, kjo Njesi ka si qellim permiresimin e vazhdueshem te cilesise permes ushtrimit te funksioneve te saj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Fakulteti Ekonomik me Departamentet perberese si dhe ne bashkepunim me Njësine e Sigurimit të Cilësisë krijojne komisione adhoc per monitorimin, shqyrtimin, mbikeqyrjen dhe rishikimin e programeve te studimit te ciklit te pare. Per shkak te numrit te vogel te studenteve dhe te praktikave te njejta te ndjekura Departamentet kryejne mbledhje te perbashketa ne funksion te proceseve te siperpermendura (Shih proces-verbal i mbledhjes dt. 30/09/2018, se</p>



	Departamenteve te Fakultetit Ekonomik per planin mesimor dhe shperndarjen e lendeve).			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Per ecurine dhe mbarëvajtjen e programeve institucioni monitoron periodikisht nepermjet instrumenteve te meposhtem: 1. Anketimi i studentëve me anë të një pyetësori 2. Mbledhjet e hapura 3. Vlerësimi i pedagogut në orën mësimore. Perdorimi i mekanizmave eshte relativisht i ri, keshtu ngelet per t'u vleresuar efikasiteti i mirefunksionimit te tyre.			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Per sa I perket rezultateve te instrumentave vleresues e monitores, edhe pse jane permendur ne Raportin vjetor te NJSBC, nuk ka nje analize te mirefillte te tyre per te kuptuar cfare eshte vleresuar dhe si ka qene ecuria e vleresimit, nese jane mare masa apo ka ndonje plan aksioni per to. Sugjerohet qe rezultatet e mekanizmave te vleresimit dhe te sigurimit te behen te njohura tek Departamenti, tek stafi akademik dhe te perfshihen ne nje process vetevleresimi te stafit akademik. Po ashtu te analizohen dhe te perfshihen ne Reportet vjetor te Departamentit dhe ne ate te NJSBC.			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Ne raportet vjetore te Departamentit dhe ne raportin e NJSBC duhe te perfshihet nje analize e detajuar e matesve sasior dhe te adresohen mangesite e ndryshme per permbushje.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Departamenti i Menaxhim Biznesit i cili është përgjegjës për programin e studimit nen shqyrtim, ben vlerësime periodike te brendshme per programin e studimit dhe i pasqyron në raportin vjetor të analizës mësimore në nivel departamenti. Gjithashtu, departamenti realizon në mënyrë periodike analizë të punës mësimore, ecurinë e programit tëstudimit duke evidentuar problematika t dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik dhe personelit ndihmës në departament, por edhe në nivelet tjera më të larta në qoftëse është e nevojshme. Ky vit eshte viti i pare i akreditimit te programit te studimit dhe KUQ ka perflshire keto analiza perv etevleresim të brendshëm dhe vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të	KUQ perpiqet te menaxhoje dhe garantoje cilosine e programit te studimit duke perdorur metoda e instrumente te ndryshme per



<p>posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>kryerjen e vlerësimit dhe matjen e performances se programit. <i>Senati Akademik, Fakulteti Ekonomik diskutojnë e miratojnë standartet në përputhje me Kodin e Cilësisë të ASCAL bazuar në Vendimin e KM Nr. 531 datë 11.09.2018, të cilat përdoren për hartimin raportit vjetor si dhe ato të akreditimit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>NJSBC përcakton bashkëpunimit me departamentin, angazhon edhe zyrat e tjera të institucionit, si ajo e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Keshillimit të Karrieres, për të kontrolluar procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore, duke përdorur metoda të drejtpërdrejta monitorimi si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së praktikave dhe ushtrimeve, testime të standardizuara, leksioneve të hapura etj, për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. <i>Fakulteti Ekonomik me departamentet për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metoda të tërthortasi sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; intervista të drejtpërdrejta; dëgjime në auditor; testime paraprake dhe përfundimtare; provime për modulet, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>KUQ, diplomon brezin e parë të studentëve në mbarim të këtij viti akademik. Në Manualin e Cilësisë në KUQ, shprehet që studentët inkurajohen të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, nëpërmjet vlerësimit dhe ofrimit të mendimit të tyre pasi ata nëpërmjet përfaqësuesve janë pjesë e Senatit, Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të KUQ këshillave studentore, Komisionit të Etikës, etj, por në praktike, KUQ nuk ka përfaqësues të studentëve të cilët të jenë pjesë e sigurimit të cilësisë së programit.  Sugjerohet të këtë përfshirje të stajit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;"><b>X</b></p>				

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e</p>	<p>KUQ harton standardet për sigurimin e cilësisë të institucionit në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Institucioni ka shpërndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (departament,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>fakultet, reaktorat) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj, por personeli mbulon njekohesisht me shumë se një pozicion administrative.  <i>Veprimtaria e NJSBC është e rregulluar sipas rregullores Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila është bazuar në ligjslacionin në fuqi dhe Statutinë Kolegjit Universitar „Qiriazi”.</i>  Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullorja e NJSBC-se përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.  <i>Zyra NJSBC sipas KUQ përbëhet nga drejtuesite zyrës, tre anëtarë të personelit akademik dhe një përfaqësuesi studentëve.</i> Por në takim nuk patëm asnjë përfaqësues të studenteve dhe as raporti vjetor I NJSBC nuk është firmosur prej ndonjë përfaqësuesi studentesh.  Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti I Menaxhimit të Biznesit është njësi bazë përgjegjëse për cilësinë e programit. Disa nga anëtarët e departamentit janë pjesë e komisioneve të tilla si Komisionet për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Rregullorja e institucionit, Rregullorja e FE dhe Rregullorja e NJSBC, parashikon angazhimin e anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.  Nga vizitat në institucion shihet e nevojshme të rekomandohet që stafi akademik të informohet dhe përfshihet në implementimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vycra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>KUQ ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vycra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Plot përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>KUQ ka nje procedure per vleresimin e mbarevajtjes mesimore. Insitucioni zhvillon nje pyetesor me studentet per vleresimin e moduleve dhe profesoreve ne fund te cdo semestri. Rezultatet e pyetesoreve i vihen ne dispozicion drejtuesve te insitucionit si edhe vete profesorit. Ato diskutohen ne mbledhjet departamentale dhe merren masat e nevojshme ne rast problematikash.</p> <p>Por ne NJSBC përfshihen personel i brendshëm i Universitetit; nuk ka anëtarë të jashtëm të pavarur dhe as përfaqësues të studentëve. Po ashtu anëtarët e saj janë mbajtës të disa funksioneve të tjera pedagogjike apo administrative, cka e vë në diskutim funksionin e saj të pavarur, sic e pasqyron organograma.</p> <p>Sugjerohet të ketë përfshirje të stalit të pavarur për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>NJSBC harton një planvjetortë përvitshëm,ku parashikon te gjitha proceset e kontrollit dhe vlerësimit. Me pas harton raportet me gjetjet përkatëse. Raporti shpalletpublikisht. Gjithashtu NJSBC informon në mënyrë periodike rektoratin, drejtuesit e fakulteteve,përmes tyre në mënyrë konfidenciale të gjithë stafin e KUQ rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisve të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Pas rezultateve te vleresimit, NJSBC-jaudhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre, duke dhene sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë. Propozime te NJSBC shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në vendimmarrje konkrete.</p> <p><i>Vitin e kaluar për RVJ institucional nga ASCAL pasi u diskutua në të gjitha nivelete organevedrejtuese sidheNJSBCE KUQ u hartua një plan masashpërzbatimin edetyrave që dolen pre jtij.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJSBC ne KUQ harton raporte vjetorete vlerësimit të Brendshëm ku pasqyron rezultatet e vazhdueshme teveprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të institucionit. Këto raporte dergohen ne MASR. Gjithashtu diskutohen në Rektorat dhe Bordin e Administrimit,u bëhen të njohura strukturave përgjegjese të Institucionit me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisëse programeve te studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>KUQ i kushton rendesi trajnimit te stafit përpërmirësimin njohurive të tyre mbi metodikën e mësidhënies,si dhe njohjen e rregulloreve të brendëshme të institucionit. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimitte pedagogëve, të rinj, në drejtim të përgatijes pedagogjike e psikologjike të tyre. KUQ organizon leksione te hapura dhe takime te drejtuesve të institucionit me studentët, merr mendimin e studentëve, nepermjet këshillit studentor, mbi çdo program studimor në tërësi, apo për çdo lëndë e pedagog të veçantë.</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Menaxhim Biznesi” të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Qirjazi”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Përmbajtja e programit, lëndët/modulet dhe veprimtaritë formuese, raportet midis tyre janë organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, për t'i ofruar studentëve njohuritë përgjithshme, aftësi profesionale dhe kompetenca për tregun e punësimit.
2. Cilësia e personelit akademik,eksperienca dhe kualifikimet mundësojnë cilësi të lartë në mësimdhënie dhe në aktivitetet e tjera akademike.
3. KUQ është angazhuar maksimalisht duke krijuar forma të ndryshme bashkëpunimi në funksion të të gjitha proceseve akademike në institucion.
4. Numri i vogël i studentëve ndikon pozitivisht në cilësinë e mësim dhënies krijimin e marrëdhënieve të drejtpërdrejta pedagog-student
5. Mbështetja ndaj studentëve është e formave të ndryshme që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tyre, kjo e favorizuar edhe nga numri i ulët i studentëve.
6. Impenjë dhe seroziteti i drejtuesve të institucionit, eksperienca e stafit dhe mundësitë që ato vënë në funksion të kolegjit, janë një vlerë e shtuar për programin e studimit.

**Pika të dobta:**

1. Programi i studimit ka me tepër karakter kontabilitet-financiar, bazuar kjo në aftësitë e studentëve që përfitohen në përfundim të programit të studimit, dhe grupi B – (Lëndë karakterizuese).
2. Kryerja e praktikave vetëm në sektorin banker, pavarësisht listës së bashkëpunimeve që disponon insitucioni.



3. Mungon një studim i mirëfilltë tregu ku të analizohen nevojat e tregut të punës sot dhe identifikimin e atyre moduleve/lëndëve të reja që do të pasuronin kurrikulen e programit të studimit. Gërshetimi i këtyre nevojave me njohuritë profesionale do të mundësonin përgatitjen e specialisteve që i mungojnë tregut të punës sot.
4. Mungon një Plan Strategjik i detajuar ku të bazohet ecuria e programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
5. Fondi i bibliotekës, është i kufizuar në numër dhe botime të reja, dhe nuk ka burime online të cilat do të nxisnin dhe pasuronin punën studimore-kërkimore të studentëve dhe stafit akademik, në mbështetje të programit.
6. Zyra e Burimeve Njerëzore ka mangësi në dokumentacionin e PAE dhe PAK, si edhe numri i zyrave disponibël është i kufizuar për akomodimin e stafit efektiv në institucion.
7. Mungon një plan-buxhet i detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond i vecantë për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/aksesin në bibliotekat on-line.
8. Mungon përfshirje e stafit të pavarur dhe përfaqesuesit të studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.
9. Sekretaria mësimore paraqet mangësi për plotësimin e të gjithë numrave të matrikullimit të studenteve të programit të studimit.
10. Mobiliteti i studentëve në institucionet partnere jashtë vendit është ende në nivel të ulët për shkak të kohës së shkurtër të funksionimit të institucionit.
11. Niveli i studentëve është nën nivelin mesatar të studentëve që regjistrohen në institucione të arsimit të lartë.

#### **Rekomandime:**

1. Të forcohet Programi i studimit për të reflektuar më tepër profilin e biznesit përkundrejt atij financiar. Për këtë duhet të rishikohen dhe riorganizohen:
  - aftësitë e studentëve që përfitohen në përfundim të programit të studimit,
  - grupi B – (Lëndë karakterizuese) duke përfshirë më tepër lëndë të profilit të Biznesit për ti ardhur më në ndihmë formimit profesional të studentëve në fushën e menaxhimit të biznesit. Kjo duke parë përqindjen më të vogël që zënë lëndët e profilit të biznesit (16%) përkundrejt 28% lëndë të profilit kontabilitet-financë, brenda lëndëve të grupit B,
  - kryerja e praktikave pranë bizneseve, jo vetëm në sektorin bankar,
  - ti jepet prioritet përdorimit të programe kompjuterike specifike në fushën e menaxhimit të biznesit p.sh Microsoft Project në lëndën e Menaxhimit të Projekteve, jo vetëm programit Financa 5.
2. Të kryejë një studim të mirëfilltë tregu ku të analizohen nevojat e tregut të punës sot dhe identifikimin e atyre moduleve/lëndëve të reja që do të pasuronin kurrikulën e



programit të studimit. Gërshetimi i këtyre nevojave me njohuritë profesionale do të mundësonin përgatitjen e specialisteve që i mungojnë tregut të punës sot. Kjo gjë do t'i jepje një avantazh konkurrues edhe vetë institucionit në të ardhmen.

3. Të hartojë një Plan Strategjik të detajuar ku të përfshijë edhe implementimin e gjetjeve nga një Studim i ri- i mirëfilltë tregu.
4. Të përditësohet Rregullorja e institucionit dhe programit me kërkesat ligjore për pranimin dhe transferimin e studentëve duke pasqyruar qarë kriterin e notës mesatare (mbi 6).
5. Të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues si edhe të beje përpjekje për t-u anctarsuar në burime online të cilat do të nxisnin dhe pasuronin punën studimore-kerkimore të studenteve dhe stafit akademik, në mbështetje të programit.
6. Të plotësohet dhe firmoset dokumentacioni i PAE dhe PAK në zyrën e Burimeve Njerëzore, si edhe të krijohen kushtet për akomodimin e stafit efektiv me zyra në institucion.
7. Të hartohet një plan-buxhet i detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond i vecantë për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/aksesin në bibliotekat on-line.
8. Institucioni dhe NJSBC vecanërisht, të shtojnë përpjekjet që stafi akademik të informohet dhe përfshihet në implementimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë. Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.
9. Të bëhet analiza vjetore cilësore dhe sasiore si e procesit të mësimdhënies edhe e kualifikimit shkencor të personelit akademik.

Sekretaria mësimore të marrë masa për plotësimin e të gjithë numrave të matrikullimit të studentëve të programit të studimit.






**Conclusions of the Evaluation of study program Bachelor in Business Management of University College "Qirjazi"**

**Strengths and affirmations:**

1. Program content, courses/modules and training services, their relationship comply with the legislation in force and serve to equip students with knowledge, skills and competence required in the labor market.
2. The quality of the academic staff, their experience and qualifications contribute to the quality of the modules offered as well as other curricular activities.
3. KUQ has been maximally engaged in creating different forms of cooperation for serving to all academic processes in the institution.
4. The low number of students creates the opportunity for an interactive learning process and direct communication between instructors and students.
5. Student support is of various forms from the moment of enrollment to graduation, this being favored also by the low number of students.
6. The support of the administrator to create the proper organizational infrastructure as well as to finance the activity shows dedication to increase the quality of this college and of the offered programs.

**Weak Points:**

1. The study program is more of an accounting-financial nature based on the ability of students who are completing the study program and group B (characteristic subject)
2. Conducting practices only in the banking sector, despite the list of collaborations that this institution possesses.
3. There is a lack of a proper market study to analyze the needs of the labor market today and identify those new modules / subjects that would enrich the curriculum of the study program. Combining these needs with professional knowledge would enable the preparation of specialists lacking in the job market today.
4. There is a lack of a detailed strategic plan based on the progress of the study program in line with labor market requirements.
5. The library fund is limited in numbers and new publications, and there are no online resources that could stimulate and enrich the research work of students and academic staff in support of the program.
6. The Office of Human Resources lacks the PAE and PAK documentation, and the number of offices available is limited to accommodate effective staff at the institution.
7. There is a lack of a detailed budget plan with relevant items for the training support and a special fund for research / academic activities for the professional development of academic staff, library expenses and literature enrichment / access to online libraries.
8. There is a lack of involvement of independent staff and student representatives to perform the function of ensuring quality with integrity and quality.
9. The teaching secretariat represents a shortcoming for the completion of all matriculation numbers of the study program students.






10. Student mobility in partner institutions abroad is still at a low level due to the shorter operating time of the institution.
11. The level of students is below the average level of students registered in higher education institutions.

**Recommendations:**

1. To strengthen the study program in order to emphasize more the its business profile versus the financial one. To this end, the following should be reviewed and reorganized:
  - the skills students will obtain after the completion of the study program,
  - group B subjects - (core subjects) including more Business Profile subjects to assist in the professional training of students in the field of business management. This, given the smallest percentage of business profile subjects (16%) versus 28% of accounting-finance profile subjects, within Group B subjects,
  - conducting professional practices (internships) not only in the banking sector,
  - prioritize the use of specific software in the area of business management e.g. Microsoft Project in Project Management, not just Finance 5.
2. To conduct a proper market study to analyze the needs of the labor market today and identify those new modules/ subjects that would enrich the curriculum of the study program. Meeting these needs with professional knowledge would enable the preparation of experts who lack in the labor market today. This would give the institution itself a competitive advantage in the future.
3. To develop a detailed Strategic Plan including implementation of findings from a genuine Market Research.
4. To update the institution and program regulations with the legal requirements for admission and transfer of students, clearly reflecting the criteria of GPA (above 6).
5. To develop and implement a detailed plan for adding library items, updating existing editions as well as making efforts to subscribe to online resources that would foster and enrich the research and research work of students and academic staff, which would better support the study program.
6. Complete and sign the PAE and PAK documentation in the Human Resources office, as well as create conditions for the accommodation of effective staff with offices in the institution.
7. Develop a detailed budget plan with relevant items to support trainings and a special fund for research / scientific activities for the professional development of academic staff, library expenses and literature enrichment / access to on-line libraries.
8. The institution and the NJSBC, in particular, should add efforts for academic staff to be informed and involved in the implementation of quality assurance mechanisms. It is suggested to involve independent staff to perform quality assurance functions with integrity and independence.





9. Conduct annual qualitative and quantitative analysis of both the teaching process and the scientific qualification of the academic staff.

The teaching secretariat takes measures to complete all matriculation numbers of the study program students.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Dr. Albana Madhi

2. PhD. Eriona Shtëmbari



